



S. I. PRIFTI

Figura e Skënderbeut simbol i popullit të vet

92(496.5)

S

566

Biblioteka Pedagogjike

STEFAN I. PRIFTI

FIGURA E SKËNDERBEUT,
SIMBOL I POPULLIT TË VET

566

23336

SHËTËPIA BOTUESE E LIBRIT SHKOLLOR
QENDRALE PËR

SHTËPIA BOTUESE E LIBRIT SHKOLLOR
TIRANË, 1963

Ky punim me titullin: «*Figura e Skënderbeut simbol i popullit të vet*» është i kufizuar në veprën monumentale të M. Barletit «Historia e Skënderbeut». Ne mendojmë se ky kufizim nuk e çduk mundësinë e trajtimit të një teme të tillë brënda kuadrit vetëm barletian, sepse askush më mirë se Barleti nuk e ka pikturuar dhe nuk e ka pavdekësuar me zjarrin e atdhe-dashurisë në zémër figurën e kryetimit tonë legjendar në tërë gjerësinë dhe shumanëshmérinë e saj. Qëllimi i punimit është të tregojë se kjo figurë e Skënderbeut, e pikturuar nga Barleti, është në esencën e saj një shprehje e koncentruar e figurës së vetë popullit në tiparet themelore të saj dhe e aspiratavet të tij për liri e pavarësi.

Skënderbeu, si gjithë heronjtë në histori, është pjellë e kohës dhe e popullit të vet. Ai lindi, jetoi e veproi në një periudhë historike jo të zakonshme për popullin tonë. Në shekullin XV, zhvillimi ekonomik, i realizuar në botën evropiane, dhe paralelisht me të zhvillimi kultural, i konkretizuar në rrymën progresive të *humanizmit*, i cili ngrihej kundër obskurantizmit, kundër fatalizmit dhe nihilizmit fetar të mesjetës, rrymë që shënoi fillimin e *Rilindjes*, ishin shënjat që para-

Iajmëronin vdekjen e botës së vjetër të rendit feudal të CCP-ëzuar dhe lindjen e një bote të re me shtete nacionalë të përqëndruar. Këto shenja e kjo erë e humanizmit frynte jetëdhënëse edhe në Shqipërinë tonë të asaj kohe. M'anë tjetër, rieziku i ri, që lindi nga invadimi turk, i cili filloj me pushtimin e disa qyteteve të Thrakës nga mezi i shek. XIV dhe vazhdoi pastaj të bënte përpara drejt shtetevet të Ballkanit dhe të Evropës qendrore, nxirrte edhe për popullin tonë detyrën e veçantë dhe nevojën e domosdoshme për të mbrojtur lirinë dhe pavarësinë e tij. Pas një rezistence të gjatë për të evituar pushtimin e vendit dhe pas disa vjet luftash e fitoresh të veçuara për të eliminuar rendin e ri feudal ushtarak turk, shpresat dhe përpjekjet e tij përfunduan në dështim të plotë dhe në robëri të egër. Por populli nuk e duronte dot robërinë. Në mendje, dhe në zemër të tij vazhdonin të vlonin të pashuara dëshirat më të zjarra, dhe tendencat më përparimitare të kohës: dashuria për liri e pavarësi, për atdhe e dinjitet njerëzor, për ndër e krenari kombëtare, besimi në drejtësinë e çështjes që mbronte dhe në forcat e yeta, vendosmëria e paepur pér ta bëré realitet detyrën e shënjtë të çlirimt nga robëria turke etj. Populli gjithashtu tanj e ndjente plotësisht nevojën e zëvëndësimit të rendit shtetëror feudal të copëzuar me krijimin e një shteti shqiptar të përqëndruar, sepse kjo nevojë dilte në këtë kohë e theksuar në Shqipëri nga rreziku që kishin përpara dhe që duhej t'i bënin ballë. Prandaj populli, i gjenjyer në shpresat e veta me përpjekjet e veçuara, po përpinqej tanj të siguronte çlirimin dhe lirinë e vet me mënyrë të re, duke i bashkuar të gjitha forcat në një front të vetëm. Pikërisht

në këtë kohë del në skenë Skënderbeu, i cili i kuptoi më mirë se kushdo tjetër aspiratat për liri të popullit, sepse «mëndja e tij», thotë Barleti, «s'e harronte lirinë»^{a)} (I, 62), b) si vetë populli, dhe prandaj, kur parësia e vëndit e ftonin «për të rifiuar lirinë e humbur», ai «lavdëronte vullnetin e të gjithëvet dhe kujtimin e pasuar të lirisë në zëmrat e popullit» (po aty). Kështu, pra, Skënderbeu, i ftuar nga populli, në krye të popullit dhe së bashku me popullin, bëri atë që bëri, *mbrekullinë shqiptare të shek. XV.*

Barleti gjithashtu është një pjesë e po atij shekulli dhe bir i denjë i po atij populli. Ai lindi e u rrit në atë kohë, kur lufta vigane e popullit shqiptar me Skënderbeun në krye ishte ngjitur në majën më të lartë të saj;^{b)} ai, pas vdekjes së kryetimit, veproi edhe me armë në dorë për të mbrojtur atdheun e vet (Shkodrën); më në fund ai, pas robërimit definitif^{c)} të Shqipërisë, u detyrua të marrë rrugën e mërgimit dhe atje, në dhe të huaj, e shkroi veprën, me atë kujtimin dhe zjarrin e mallit të pasuar për atdheun e humbur, në bazë të dhënat kryesisht nga shokë dhe bashkë-luftëtarë të Skënderbeut. Si rrjedhim, ai e njihte mirë situatën komplekse, në të cilën u zhvillua lufta e madhërishme shqiptare, njihte mirë popullin, jetën, zakonet, mendimet e tij, aspiratat, synimet dhe përpjekjet për t'i realizuar, njihte *frymën dhe heroikën e kohës bashkë me adhurimin e përgjithëshëm ndaj kryetimit*. Kjo rrëthanë përbën bazën objektive të pa-

-
- a) Referimet bëhen në veprën e Barletit «Historia e Skënderbeut», përkthim shqip. Tiranë 1964
- b) Barleti thuhet se lindi nga mezi i shek. XV (1450)
- c) 1478 – 1479.

tundur, mbi të cilën mbështetet ndërtimi i veprës së Barletit. M'anë tjetër, kushdo që e lexon me vëmëndjen e duhur këtë vepër monumentale të Barletit, nuk mund të mos konstatojë e të mos bindet se kujdesi i tij për të siguruar të vërtetën historike të faktevet, që pëershruhen e përbahen në të, është i madh e i lavdërueshëm. Ai i shoshit dhe i diskuton çështjet duke u mbështetur në përfundimin e ngjarjeve, ashtu siç e kërkon «rregulli dhe ligji i historisë»; ai ka hall të madh për *të vërtetën*, me qëllim që t'ua lërë brezave të ardھeshëm sa më të pastër e më të kulluar. Ai thotë në një rast tekstualez kështu: «Por rregulli dhe ligji i historisë është që, kur shumë gjëra të gabuara janë të përziera me të vërteta, të rrihen e të shoshiten mirë, me qëllim që të pastrohen si në ujë të kulluar përrrenjsh dhe të ngelin të llagarta për ata që do t'i lexojnë këto shkrime tona» (VII, 289). Me gjithë këtë, disa historianë kanë pohuar se vepra në fjalë e Barletit dhe figura e Skënderbeut, e simbolizuar në të, janë më fort krijime fantazie, shpikje ose trillime të paqëna, se Barleti është më fort një përrallathurës e hartues «romanesh» pa currfarë vlere etj. etj. Por ata s'kanë të drejtë; ata gabojnë dhe bile rëndë e me një farë lehtësie të palejueshme, sepse pohimet e tyre nisen jo nga janë esenciale të veprës, por kryesisht nga forma dhe nga ndonjë gabim në hollësira, ato mbështeten kryesisht në stilin dhe në ndonjë hollësi informative të lajthitur të saj. Prandaj këto pohime janë të *përcipta* dhe të tepëruara. Por ndoshta madhështija brendimore e veprës, e pazakontë për ta, i bën që ta humbasin toruan e të hutohen para kësaj *mbrekullie shqiptare*, të rrallë në historinë e njerëzimit. Dhe është fat për

popullin dhe historinë tonë që u ndodh Barleti, ky sokol i pendës dhe gjer diku i pushkës, që, me zëmrën, e tij të zjarrtë prej shqiptari të kulluar dhe me mëndjen e tij të lartë e të mprehtë si vetë shpata e kryetimit, e la të pavdekshëm këtë realitet historik të vepruar plotësisht dhe të jetuar pa dyshim në atdheun tonë heroik, *luftën e madhërishme shqiptare për 25 vjet me radhë me Skënderbeun në krye*. Dhe e la në atë formë që mund ta linte, sepse, përveç të tjerave, siç do të shohim, «Fajin, na duket», siç thotë bukur Noli «s'e ka aqë Barleti sa Skënderbeu, i cili ua rrëmbeu mëndjen edhe atyre historianëve më gjakftohët.»^{a)} Dhe Barleti s'mund të ishte gjakftohtë, aqë më tepër, kur veprën e shkruan, siç thamë, larg atdheut, i mërguar në dhe të huaj, me zjarrin e dashurisë dhe të mallit të pashuar për të në zëmër.

Në këtë luftë të shënjtë e legjendare të popullit tonë u çfaqën në shkallën më të lartë vetitë më të shënuara dhe më të shquara të tij. Barleti, duke ia veshur këto Skënderbeut dhe duke i shprehur të koncentruara përmes figurës së tij, nuk i shpik ato nga jashtë, — se s'është kollaj të shpikësh një Skënderbe!, — por i merr nga brënda, ngajeta, nga populli dhe vetë Skënderbeu. Barleti, si humanist, ndodhet nën influencën e shumanëshme të shkrimitarëve antikë, grekë dhe latinë, ai shkruan në bazë të parimit *artistikolettar, estetik* dhe të *utilitetit* të historisë. Këto parime e shikonin historinë dhe *si art*, ato i caktonin asaj dhe qëllime të tjera, jo vetëm tregimin e thatë të ngjarjeve.

a) F. Noli, «Histori e Skënderbeut», Boston 1921, f.15. —

Nën **Influencën** e këtyre parimeve, stili i Barletit është poetik, i figurëshëm, impresionant, vërshonjës e fort i lulëzuar, me tendencë zmadhonjëse, plot pane gjirizëm në fjalimet dhe tërë retorizëm të dallgëzuar në përgjithësi. Barleti madje kur ia do puna e ia lejon rasti, nuk nguron të shtjerë në punë edhe *legjendën* e *mbrekullinë*, sepse ai shkruan gjithëmonë me sytë të kthyer nga populli dhe të mbërthyer në adhurimin e popullit ndaj kryetimit; por me këtë ai qëndron më afër *mënyrës popullore* të konceptimit, të shpjegimit dhe të idealizimit të faktevet historike. Dhe në kohën, kur Barleti mori në dorë pendën për të shkruar «Historinë e Skënderbeut», figura e kryetimit tonë ishte rritur, shtuar e zmadhuar nga imagjinata popullore dhe nga dashuria e kujtimi i emrit dhe i trimërvet të tij. Por edhe *legjenda* e *mbrekullia* mbështeten në një fakt, edhe ato fshehin një brendi, që ne duhet ta zbulojmë e ta gjejmë. Dhe historia s'mund të kuptohet kurrë drejt, po s'u nisëm nga populli, po e harruam popullin, në çfarëdo forme që mund të shprehet ai.

Këto tipare stilistike natyrisht sikur nuk i shkojnë historisë, rreptësisë shkencore të saj, por ato s'e prekin dot objektivitetin në brendi të faktevet, sepse kanë të bëjnë me *formën*. Forma, sado e lulëzuar apo e fryrë, sado e zbukuruar apo e zmadhuar që të jetë, s'mund ta çdukë brendinë, esencën e brëndëshme të saj, bërthamën e zjarrtë, që e ushqen, e rrit dhe e zbukuron këtë formë, mjafton që ajo të vështrohet drejt dhe që faktet të çvishen prej saj. Kështu ndodh edhe me Barletin dhe kështu duhet vështruar forma edhe tek ai. Atëhere ne nuk do të mund të pajtohemi kurrsesi me ata, që mohojnë vlerën e Barletit, dhe do ta kemi të

qartë pa asnjë dyshim se ai, përmes formës hiperbolike të tij, shpreh një realitet objektiv të pamohueshëm, por dhe të madhërishëm, aqë sa forma e madhërishme barletiane e shprehjes sikur i shkon e i përshtatet jo keq.

Pohimet e historianëvet, pra, që e cilësojnë veprën e Barletit si kujim fantazie dhe të pavlerë, janë të *përcipta* dhe të *tepëruara*. Të përcipta, sepse ato *qëndrojnë në sipërfaqe*, të *tepëruara*, sepse *përgjithësohen*.

Le të shtojmë, para se të fillojmë nga detyra kryesore e këtij punimi, edhe diçka tjetër në favor të mendimit tonë se Barleti nuk është një thurës romanesh e përrallash, por një «shkrimtar shumë i kujdesur në ndriçimin e çështjeve të Epirit «siç ka thënë bukur Bardhi ynë^{a)}). Barleti është i vetëdijshëm dhe e pohon vetë se në ndonjë rast e tepëron në pikëpamje të stilit, porse këtë e bën jo pa ndonjë qëllim.

Stili i Barletit, përcaktohet edhe nga qëllimi, që ai i vërtejtës në këtë vepër. Dhe qëllimi kryesor i tij është që të vëré në dukje mirë e sa më me forcë përbajtjen e madhërishme të luftës legjendare të popullit tonë me kryetrimin e tij legjendar në krye dhe gjithash tu format e madhërishme të shtjellimit të saj, të tregojë forcën e paepur të popullit dhe heroizmin e tij të pashoq në luftën për liri, me formën gjithash tu më të madhërishme dhe më impresionante të stilit të tij poetik, vërvonjës e fort të lulëzuar, sepse kështu mendon se do t'ia arrijë më mirë qëllimit edukativ për të ngjallur në popullin e për të mbajtur në të të pashuar dashurinë për atdhe, për të pavdekësuar vetë popullin dhe heroin e tij. Pa mbajtur parasysh këtë qëllim të Barletit në veprën e tij, ne nuk mund ta vlerësojmë

a) F. Bardhi, «Skënderbeu», Tiranë 1957, f. 49.

atë drejt, sepse dielli nuk mbulohet me shoshë, siç thotë populli.

Më në fund le të themi se të dhënat e Barletit i konfirmojnë edhe kronikanë të ndryshëm të kohës, si bizantinë, turq etj. Kështu Halkokondili flet për një «rezistencë të pashpresuar» të shqiptarëvet kundër Mehmetit II, duke admiruar trimërinë e tyre; Ashik Pashë Zaideja pothon kryengritjen e Skënderbeut kundër Muratit dhe humbjet turke në Shqipëri; Sabeliku admiron trimërinë dhe heroizmin e Skënderbeut në Itali, ku luftonte «*krahëçveshur*», siç thotë edhe Barleti, duke i kallur tmerrin armikut. Kështu edhe shumë të tjerë. Edhe historiografia jonë e re çdo ditë e më tepër po i konfirmon të dhënat e Barletit me dëshmi të reja. Por objektivitetin e Barletit e tregon më mirë se kushdo tjetër *vetë populli*, siç do ta shohim më poshtë, e tregon «mendimi i përgjithshëm i kombit tonë» ^{a)}, siç e ka thënë bukur Bardhi ynë, ky patriot i flaktë dhe mbrojtës i drejtë i Skënderbeut, sepse populli e ka ruajtur të gjallë e të pavdekur në zëmër e në mëndje për shekuj me radhë kujtimin dhe adhurimin për kryetimin, sepse në figurën e Skënderbeut të Barletit mi-shërohet vetë populli, tiparet dhe vetitë e tij më të bukura, aspiratat e tij për liri e pavarësi, sepse Skënderbeu është për jetë e mot i pavdekshëm në shpirt të popullit. E vërteta, pra, objektive e pamohueshme, që s'mund të hidhet poshtë nga asnjeri, mbetet kjo, se Barleti, i cili shkruan kurdoherë me sytë të kthyer nga populli dhe të mbërthyer në adhurimin e popullit ndaj kryetimit, me stilin dhe formën e tij hiperbolike, përmes figurës së Skënderbeut të ngritur në simbol,

a) F. Bardhi, V. C., f. 74.

ka mundur të ruajë, të shprehë e të pavdekësojë esen-
cën themelore të realitetit historik të asaj kohe, *shpir-
tin e popullit*, që krijon historinë. Këtu qëndron vlera
kryesore dhe e paçmuar e tij.

II.

Skënderbeu është përkryesi më i mirë i aspiratavet popullore të kohës për liri e pavarësi, prandaj edhe shprehësi dhe mëshironjësi më i denjë i cilësivet më të shquara, trupore dhe shpirtërore, të popullit. Vepra e Skënderbeut është vepër e vetë popullit, të udhëhequr prej tij, prandaj edhe figura e tij është shprehje e figurës së vetë popullit, e vetivet të tij më të larta dhe e aspiratavet të tij më të bukura për liri. Skënderbeu është një «Kapedan popullor», siç thotë Barleti, dhe është i tillë tërësisht, në mëndje e në-zemër, në fjalë e në vepra, në dorë e në shpatë, sepse vepra e tij mbështetet e tëra në popull. Prandaj edhe figura e tij shpreh e përgjithëson tërësisht popullin, mëndjen, zemrën dhe dorën e tij të pathyeshme. Prandaj populli i shkon atij pas e s'i ndahet kurrë, i vendosur ja të fitojë dhe të sigurojë kështu nderin dhe lirinë, ja të vdesë bashkë me të; prandaj përkrahja e popullit për të është e admirueshme, një «mbrekulli», që s'i ka ndodhur kujt në atë shekull (II, 104); prandaj populli e do dhe e admiron këtë bir të vet si askënd, duke e ngritur në simbol të vetvehthes.

Skënderbeu është një «YII i ndritur e i bukur i Arbërisë» dhe Barleti, me ndjenjën e admirimit legji-
tim, e quan një *mbrekulli* të shekullit për ta admiruar

njerëzia (II, 103). Dhe me këtë ndjenjë e vështrim admirimi dhe mbrekullie e nis dhe e mbaron ai veprën e tij të pavdekshme mbi heroin tonë legjendar, duke iu përgjigjur kështu dëshirës dhe ndjenjës së vetë popullit. Dhe me të vërtetë, populli vetë e ka mbështjetëllë Skënderbeun me ndjenjën e admirimit dhe të mbrekullisë që në bark të nënës. Endëra e Voisavës, nënës së Skënderbeut, që pa se lindi një *dragua*, — apo «Kulçedrën e Arbërit»^{a)}, siç e quajti populli—, me trup që mbulonte Shqipërinë dhe me kokë të kthyer nga armiqjtë për t'i gllabëruar (I, 50), shpreh, për mendimin tim, në të vërtetë e në formë simbolike vetinë më themelore të popullit tonë: idealin e tij më të lartë e më të bukur njerëzor, dëshirën dhe vendosmërinë e e tij të papërkulur për të qenë i lirë dhe për ta mbrojtur e siguruar lirinë dhe pavarësinë e atdheut me vigjilencë dhe përpjekje të paprerë, duke gllabëruar armiqjtë nga çdo anë qofshin. Dhe djali lindi e, «kur lindi», vazhdon Barleti, «një shënjë tjeter krenarie luftarake shumë më e bukur dhe shumë më e ndritur u pa në krahun e djathtë të fëmijës, një shpatë e shkruar me një mënyrë që dukej si të ish bërë me dorë.» (po aty). Kjo shpatë, e vendosur nga imagjinata popullore në krahun e djathtë të Skënderbeut që në bark të nënës, është vetë shpata e popullit shqiptar, derdhur e skalitur në mëndje e në zémër, në krah e në llërë të tij nga zjarri i dashurisë për liri e për atdhe, shpatë, të cilën ai ka qenë i detyruar nga rrethanat ta mbajë kurdoherë të zhveshur në dorë për të mbrojtur atdheun nga lakinë e huaja; është ajo shpatë, me të cilën populli

a) F. Bardhi, V.C., f. 73.

ynë, siç ka thënë shoku Enver, *e ka çarë rrugën e historisë*; éshtë ajo shpatë e mprehtë e kërdibërëse e Skënderbeut me të cilën ai, në krye të popullit, i dolli si askush zot Shqipërisë.

Kështu Barleti, nëpërmes të legjendës e të mbrekullisë, të kësaj mënyre popullore të shpjegimit të faktave historike, ka shprehur një realitet historik të pamohueshëm, duke ngritur në simbol të popullit figurën e Skënderbeut.

Skënderbeu i vogël éshtë, thotë Barleti, «një shermend i mbarë» (I, 51), i ngarkuar me vetitë më të bukura dhe më të dashura për popullin. Që fëmijë, ai jepte prova «të trimërisë së ardhëshme» duke u zvarritur «drejt armëvet dhe shigjetavet» dhe duke u stërvitur me to që në këtë moshë. Pastaj, vazhdon Barleti, sjellja e tij, zakonet e bukura dhe të hijëshme, hiri dhe bukuria e trupit, «që hijeshon gjithëçka», këto e të tjera veti të mira, që dilnin në shesh e hidhnin shtat në të bashkë me moshën, bënин që kudo të flitej me gëzim e të pëshpëritez për të me admirim nga populli e nga gjithë njerëzia. Prandaj populli, kur Skënderbeu i vogël u muar peng bashkë me të vellezërit në oborr të Sulltanit, — ku u shqua si askush në mësimet dhe në stërvitjet trupore, duke mësuar brënda një kohe të shkurtëi, me mendjen e tij «të gatëshme për çdo gjë», «gjuhën dhe letërsinë turke, arabe, greke, italike dhe sllave» (I, 53), dhe ku ishte i pushtuar vetëm nga një dëshirë: «*të bënte gjithëmonë diçka më të madhe se mosha e tij*» (po aty), — populli, pra, që s'i gëzohej dot, «u pikëllua» atëhere sidomos për të (I, 51), sepse populli shikonte në të fëmijën ideal për çdo prind shqiptar, sepse Skënderbeu u bë për popullin *simbol*

adhurimi i moshës fëminore, sepse vetitë dhe shënjet e trimërisë së Skënderbeut ia mbushnin zëmrën popullit plot me dashuri për të dhe plot me shpresë për fatet e atdheut. «Dhe dikush nga populli», përfundon Barleti, «duke i uruar djalit jetë të gjatë dhe moshë burrërore, tha se Murati në Gjergjin kish për të rritur armikun dhe zjarrin e shtëpisë së vet» (po aty). Dhe kështu u bë. Skënderbeu, ky «shërmend i mbarë» i pemës arbërore, u rrit e u zhvillua pastaj dhe hodhi shtat e u ngrit përpjetë duke qëndruar në krye të popullit si vigan kundër dallgës otomane, *simbol i plotë dhe i denjë i tij* në luftën për liri e pavarësi.

a. — **Vetitë trupore të Skënderbeut.**

Barleti, si humanist, udhëhiqet këtu nga koncepti klasik *se trupi është pasqyrë e shpirtit*. Ai thotë, kur përshkruan cilësitë e Muzakës kështu: «Bukuria pastaj, që është një pamje e veçantë e gravet, dhe hijeshia e fytyrës dhe e trupit, ishte në harmoni dhe përshtatje të plotë me stolitë e tjera të shpirtit» (VIII, 339). Por Barleti mbështetet edhe në vlerësimin që i bën populli prioritetit trupor, të shprehur me fjalët e tij të urta: «shëndet të kemi, pa këtu jemi» etj. Në bazë të këtij vështrimi e koncepti, ai vë së pari në dukje vetitë trupore të kryetrimit në dy aspektet themelore të tyre: *bukurinë* dhe *fuginë*. Skënderbeu ka trup të bukur e të fuqishëm, të zhvilluar e të harmonishëm në tërësi e në veçanti, të pëlqyer fort ngå populli. Në ndeshjen me Skytharin e egër, ku spektatorët ia kishin ngulur sytë me shqetësim në zëmër djaloshit

Skënderbe, Barleti thotë: «Mosha, bukuria e trupit dhe hijeshia e gjymtyrëvet, që kishin para syvet, zgjoi shumë dhëmbje dhe dashuri për të. Shtati i tij i lartë e i hedhur; krahët që s'ishin parë më të bukura tek njeri; qafa e fuqishme dhe e përkulur, si e atletëvet; gjerësia e supevet e admirueshme; ngjyra e bardhë si e derdhur në të kuq të padukshëm; shikimi i syvet as i egër, as i fjetur, por shumë i këndëshëm. Këto,» vazhdon ai, «ia rritnin shumë virtutet e tjera dhe du-keshin se ia shtonin mirësinë shpirtërore.» (I,55). Barleti, pra, e konsideron trupin si një pasqyrë të shpirtit, prandaj ai i ndërgërshton këtu tiparet trupore me tiparet shpirtërore të kryetimit, duke i konsideruar të parat si bazë të të dytavet në aspektin e *fugisë* dhe të *bukurisë*.

Fuqia trupore e Skënderbeut, e cila admirohej nga populli, është e paepur, e pamposhtur dhe e pathyeshme nga asgjë. «Ai», thotë Barleti, «luftonte gjithmonë *krahëçveshur* dhe s'donte t'ia dinte as nga të ftohtit, as nga të nxehtit, duke e bërë këtë punë me një guxim t'atillë, që brezat e ardhëshëm do të çuditen më fort se do të besojnë» (I,76). E gërshtuar me fuqinë shpirtërore, ajo konsiderohet «hyjnore» d.m.th. e rrallë, mbinjerëzore në përballimin e vështirësivët dhe bazë e trimërisë së «pashterur» të kryetimit tonë legjendar. «Që nga dita e parë që erdhi në Epir e gjersa çlirroi mbretërinë, mezi i bënte dy orë gjumë çdo natë, mbrekulli kjo», vazhdon Barleti, «e një trupi hyjnor dhe e një trimërie të pashtuar» (po aty). Dhe këtë fuqi ai e pati, shpjegon Barleti, «nga që rinte ndoshta pa gjumë, nga që qëndronte në lëvizje të paprerë e në vrull të madh» (po aty). Këtë fuqi populli

e quante «një gjë të madhe» për të. Me këtë fuqi Skënderbeu jepte sipas rastit prova «që zor t'u besonje» (VIII,333). Prandaj, vazhdon Barleti, «të gjithë besonin e thonin se trupi i tij ishte hyjnor e i pacë-nueshëm, që s'i qasej as hekuri, as ndonjë goditje tjetër njerëzore». (VIII, 340). Një fuqi të tillë trupore dhe shpirtërore të pamposhtur kanë edhe ushtarët (XI, 462 etj.) edhe populli i gjithë. Por populli e admirón dhe e ngre këtë fuqi në shkallën më të lartë të saj në personin e kryetimit, duke e quajtur trupin e tij «hyjnor».

Me këtë mënyrë idealizimi hiperbolik, por popullor, figura fizike e Skënderbeut ngrihet në një *simbol* adhurimi të vetë fuqisë fizike të popullit, i cili u bën ballë kurdoherë vështirësivet e rrebeshevët me një mënyrë të pashoqe dhe nuk mposhtet para tyre në asnje rast.

b. — **Vetitë shpirtërore të Skënderbeut.**

Vetitë shpirtërore të Skënderbeut janë edhe më të admirueshme dhe e tregojnë edhe më dukshëm funksionin simbolizonjës të figurës së tij. Këto veti, për t'i studjuar, do t'i ndajmë në dy grupe, megjithëse kufitë ndërmjet tyre nuk janë të prera. Në grupin e parë hyjnë ato që kanë një karakter kryesisht mendor, intelektual kurse në të dytin ato që kanë karakter më fort moral, emocional dhe volitif, që lidhen d.m.th. më shumë me ndjenjat dhe vullnetin e njeriut dhe me idetë morale të tij.

1. — **Vetitë mendore.** — Skënderbeu është njeri me mëndje të lartë e të thellë, të hollë e të mprehtë, dhe me një urtësi që s'ka ku të vejë (I, 62). Ai di t'u japë çështjeve zgjidhje të shpejtë e të pagabuar. Ai mëson nga praktika dhe *pësimet i bëhen mësime*. «Unë e mbaj mënd», u thotë ai në një rast ushtarëvet «se më parë nga ushtarët kërkonja vetëm *trimëri*, duke lënë mënjanë me mospërfillje çdo shkak të jash-tëm... Por ajo kërdia jonë e Belgradit,^{a)}..., i ka ndryshuar shumë mendimet e mia dhe më ka bërë që t'i çmoj me një mënyrë faqe të ndryshme ngjarjet njerëzore» (IX, 360). Mëncuria dhe urtësia për Skënderbeun janë kusht për çdo sukses e fitore (IV, 181), për shpëtimin e vëndit, të nderit e të lavdisë (IX, 362), prandaj ai nuk ndërmerr asgjë «pa i bërë sytë katër, kot e pa menduar thellë» (II, 97), sepse punët duhen «më tepër bërë se sa thënë» (II, 72). Prandaj planet e tij janë «plot mëncuri» (V, 259) dhe bëjnë që të shkojnë kot shpresat e armikut. Mëncuria dhe urtësia e kryetimit tonë është aqë e madhe, aqë e lartë dhe aqë e thellë, saqë konsiderohet «hyjnore», d.m.th. e pazakontë. Këtë mëncuri e urtësi ia njojin Skënderbeut edhe të huajt, miqtë (X, 414) dhe armiqtë (XI, 456). Por, kjo mëncuri dhe urtësi e Skënderbeut është një *mëncuri dhe urtësi* e popullit, një mëncuri dhe urtësi shqiptare. Lidhur me këtë ai u thotë në një rast ushtarëvet: «Në qoftë se ju do të veproni me armët dhe *mëndjen tuaj* sipas vullnetit tim, do t'jua lë armikun në dorë, për ta grirë brënda murevet, dhe emrin e *mëndje mprehtësinë* epirote do ta bëj sot... për racën e turqvet

^{a)} Beratit. Disfata në Berat i kushtoi miaft Skënderbeut (shiko VIII, 332).

23336

më të tmeruar nga ç'mbahet, ndoshta, mënt që prej stërgjyshërvet tanë» (IX, 362 – 363). Por, që Skënderbeu të mund ta ngrejë mënçurinë dhe urtësinë populllore në majat më të larta të saj dhe të arrijë sukseset e dëshiruara, duhet të mbështetet gjithashtu në popull, në bashkëveprimin me të. Prandaj në një rast tjetër ai u thotë gjithashtu ushtarëvet: «prandaj tani është nevoja që ne të *këshillohem* së *bashku* dhe të nxjerrim prej gjëndjes që kemi përpara ato detyra, që se cili nga ju do t'i gykojë më të sigurta dhe më të ndershme, duke u nisur nga përfundimi, që është mësonjësi i të gjitha gjëravet, dhe pa ia *imponuar kujt mendimin me forcë*» (III, 137). Dhe kjo nevojë del e kuptueshme dhe e theksuar për të gjithë, po të mbahet parasysh fakti se gabimet në luftë janë të pakorigjueshëm, me pasoja të rënda, të pallogaritëshme. Këtë e thekson Skënderbeu në një rast tjetër, kur u thotë ushtarëvet, që s'po e bëjnë dot «zap vrullin» e tyre dhe s'e frenojnë dot «zjarrin e zëmrës» nga dëshira për t'u hedhur mbi armikun: «Ju e dinî sigurisht, o ushtarë, se sa i pandreqëshëm, sa i pakorigjueshëm është gabimi i Marsit.^{a)} Dhe me të vërtetë, nëqoftëse gabimi bëhet në raste të tjera, ai mund të qortohet e të ndreqet. Por, pas gabimevet në beteja, s'mbetet më vënd për ndreqje» (XII, 477–478). Prandaj «nuk duhet ndeshur apo përleshur ndonjëherë me armikun pa menduar mirë». Prandaj «bëjeni zap vrullin t'uaj, frenojeni zjarrin e zëmrës», këshillon kryetrimi (po aty) Mënçuria dhe urtësia e Skënderbeut dallohet

a) Marsi = perëndia e luftës, lufta.

kudo e kurdoherë, gjatë gjithë jetës së tij, duke konfirmuar në praktikë bindjen dhe mendimin që ai ka e shpreh para Kuvendit të Lezhës mbi fuqinë e mëndjes dhe të gjykimit njerëzor: «Përsa i përket veç mëndjes dhe gjykimit njerëzor, unë mund ta tregoj se ato janë një mjet i sigurtë për të gjitha punët sepse asgjë s'është aqë e vështirë, sa që të mos mund të zgjidhet nga mëndja e njeriut» (II, 98)

Për këtë mendim e bindje të tij të thellë mënçurie, për urtësinë dhe këshillat e tij prej kapedani gjenial, për përvojën e tij «në punët e luftës» dhe për besimin e patundur e shpresën e sigurtë «në fitoren», Skënderbeu vihet e pranohet nga të gjithë e me gjithë zëmër në krye të forcavet të bashkuara shqiptare si strateg e udhëheqës i ndritur i popullit në luftën vigane kundër barbarisë atomane; për këto atij «i besuan drejtimin suprem të të gjithë gjëndjes dhe kujdesin e luftës, e zgjodhën kryetar dhe kapedan të tyre të vetëm», duke e lavdëruar fort dhe duke e ngritur në qiell si «shpëtimtarin e lirisë dhe të të gjithë lavdisë» (II, 99–100). Dhe lufta vigane 25 vjeçare nën udhëheqjen e Skënderbeut i justifikoi plotësisht shpresat dhe gjykimin e popullit: Skënderbeu u tregua këtu strategu më i madh i shekullit dhe shprehësi më i denjë dhe më i plotë i mënçurisë së popullit tonë.

Por mënçuria dhe urtësia e Skënderbeut spikat mbi të gjitha në *taktikën* e tij. Karakteristikat kryesore të kësaj taktike, parimet mbi të cilat mbështetet, zbatimi praktik dhe përfundimet konkrete, e vërtetojnë më së miri këtë. Prandaj, për t'i konkretizuar këto pohime dhe këtë të vërtetë, do ta shqyrtojmë në

mënyrë më të veçantë taktikën e kryetrimit tonë.

Taktika e Skënderbeut. — Skënderbeu, i mbësh-tetur në eksperiencën e vëndit e në të vetën, është kundër çdo shablloni dhe skeme teorike të vendosur *a priori* dhe të zbatueshme symbyllur në çdo rast të taktikës luftarake. «Gjithëmonë për plane të reja duhen rrugë, të reja» (IX, 360), u thotë ai ushtarëvet. Duke u nisur nga ky parim, ai e mbështet taktikën e tij në dy baza themelore: në *situatën konkrete* apo «në vetë rrethanat» (III, 137), siç thotë ai vetë, dhe në *mëncurinë* e përbashkët të masës së bashkëluftëtarëvet, të popullit.

Situata konkrete duhet së pari të njihet mirë dhe për këtë është nevoja të mbahen parasysh elementët që e përbëjnë dhe që e përcaktojnë atë, siç janë në përgjithësi gjëndja e forcavet ndërluftuese, koha, vëndi, ku zhvillohen betejat etj. Së dyti ajo duhet të çmohet dhe të vlerësohet drejt dhe për këtë është e domos-doshme të shtihet në punë përvoja dhe mëncuria kolektive, duke u nisur gjithmonë nga përfundimi, i cili, siç e tha më lart, «është mësonjësi i të gjitha gjërat», sepse vlera e çdo veprimi dhe e çdo pune varet nga përfundimi, siç thotë Skënderbeu në një rast. «Me gjithë këtë dëshmitari zyrtar për ju do të jetë *vetë përfundimi* i luftës që do të jepni». (V, 207). Në bazë të kësaj përcaktohet pastaj edhe plani i veprimit, forma definitive e të cilët, thotë Skënderbeu, «do të na shkrepë në kohën dhe ditën, kur ta kemi armikun para syvet.» (IX, 362). Vetëm kështu, thekson ai, mund të gjykohet drejt: «Por këto do t'i gjykojmë më drejt», thotë, «kur të ndodhemi në vënd e të kemi përpara armikun e kur të mbajmë shpatën në këtë të djathtën

tonë shkrumbonjëse, se sa tani përsëlargu e në tym». (I, 74).

Këtu nuk na lejon vëndi, por as mundësitë tona, që të hyjmë në një analizë të hollësishme të betejavet të ndritura fitimtare e lavdiplota të Skënderbeut, për të vërtetuar në tërë shtrirjen saktësinë taktkike të tij dhe të pohimeve tona pér të. Kjo është një punë e një detyrë e specialistëvet tanë, së cilës ata mund t'i përvishen duke i bërë studimet në vënd. Ne do ta vlerësojmë taktkën e Skënderbeut në këtë punim, sikurse thamë, vetëm në aspektet e saj më të përgjithëshëm, që parashtruan më lart dhe që janë në bazë të çdo akti, beteje e luftimi të veçantë.

Mëncuria dhe urtësia taktkike e Skënderbeut spikat së pari lidhur me vlerësimin dhe qëndrimin e drejtë ndaj armikut. Këtë çështje ai e konsideron si vendimtare pér fatin e gjithë luftës shqiptare, sepse, duke u nisur nga gjëndja reale e punëvet, sidomos në Ballkan, mendon se fatkeqësítë dhe robërimi i vetë Shqipërisë, kanë si shkak, përveç të tjerave, mungesën e një vlerësimi dhe qëndrimi të drejtë ndaj armikut otoman. Këtë mungesë ai e konsideron si një *gabim tē përgjithshëm* dhe jo vetëm të babës së vet Gjon, siç thotë në Kuvendin e Lezhës, duke u tërhequr vëmëndjen të pranishmëvet: «Por ç'të qahem më tej pér prindin tim? Ky është një gabim i përgjithëshëm një fat i përbashkët pér gjithë princët e krishterë», (II, 95). Këtë gabim ata duhet ta kenë shumë mirë parasysh në kohën, kur po shqyrtojnë çështjen e bashkimit të të gjitha forcavet në një front të vetëm, sepse ky gabim vlen më shumë se çdo fjalë tjetër. Prandaj Skënderbeu vazhdon: «nuk mbetet asgjë, o etër të këtij

Kuvendi, që të mund t'ju themi ju në këtë pjesë të fjalës sime, sepse ju duhet t'i kini nxjerrë fort *mirë mësimet nga fatkeqësia e të tjerëvet*. (po aty). Dhe, duke vazhduar të sqarojë qëndrimin e gabuar të tyre ndaj armikut dhelparak otoman, shton: «Zor të gjej ndonjë popull, që të jetë përbysur prej tij me ndonjë mënyrë tjetër, veçse me dhelpërrira e me kurthe, ose me *anë të besimit* të tepëruar dhe të grindjevet të brëndëshme». (po aty). Për këto arësy Skënderbeu i jepte një rëndësi të veçantë *njoħjes* së armikut, sepse kjo, thotë, vlen shumë «në punët e luftës» (II, 97). Vetëm në bazë të njoħjes së mirë të armikut mund të vlerësohet ai drejt dhe të përcaktohet drejt qëndrimi që duhet mbajtur ndaj tij, vetëm kështu do të mund të vihet në praktikë porosia e kryetrimit që planet t'i përshtatin «sipas *gjendjes* dhe vetë planevet të armikut» (I, 82).

Njohja e armikut duhet të shtrihet në tē gjitha anët e tij, jo vetëm në drejtim tē forçavet tē tij, tē përbërjes së tyre etj., por edhe tē karakterit e tē mënyrës së veprimit tē tij. Dhe Skënderbeu e njihte mirë armikun dhe nga tē gjitha anët, ai ia dinte «shumë mirë lëkurën, dhelpëritë, mashtrimet e gjithë zakonet me radhë» (II, 97).

Përveç kësaj, ai informohej në çdo rast për planet e armikut me anë tē zbulonjësvet tē caktuar, me anë tē tē arratisurvet (V, 210), si edhe me anë tē miqvet tē tij, njerëz tē brëndëshsëm në oborr tē Sulltanit (II, 99). Kjo tregon se Skënderbeu e kishte organizuar punën e njoħjes së armikut dhe e kishte ngritur në sistem, siç thotë edhe F.Noli: «Një nga kujdesjet e tij kryesore, që kur ngriti krye, ishte tē formonte një zyrë

informate ushtëriake»^a). Prandaj Skënderbeu është në gjendje të japë dhe jep këshillat më të mira dhe më të dobishme në këtë çështje. Armikut, thotë, s'i duhet zënë kurrë besë, sado i mirë që të shqiptet (II, 95, XIII, 488). Por armiku nuk duhet gjithashtu as të përbuzet (= përcmohet), sado i ulët dhe frikacak që të jetë, sepse «armiku i përbuzur e ka vënë në dyshim fitoren» (II, 105); përkundrazi, atij duhet t'ia kemi, kurdoherë frikën (XII, 478), sidomos kur është aqë i madh, sepse kjo frikë është *urtësi* që siguron fitoren (IX, 359). Dhe Skënderbeu ia kishte kurdoherë ose shtihej nergut se ia kishte frikën armikut, me qëllim që t'i bënte ushtarët e tij sykatër e «të kishin mëndjen pér çdo gjë» (V, 205). Ai nuk «dehej kurrë nga suk-seset» (II, 112) e «koka s'i kishte marrë» kurrë «aqë erë, sa që të mos u trëmbaj armiqvët» (IV, 189) dhe thoshte: «Është mirë ta kemi të gjithë këtë frikë, që të mos trëmbemi pastaj pér asgjë» (IX, 362). Ai i illustron mendimet e tij, të nxjerrë nga përvoja e përditëshme, edhe me shëmbëlla nga historia: «Që këndeja ka rrjetdhur edhe mundësia që ne të dëgjojmë se kapedanët e vjetër, që ia kishin frikën çdo gjëje, fitonin zakonisht më mirë se ata që s'trëmbeshin pér asgjë» (IX, 359). Me anë të kësaj frike, pra, që është në të vërtetë *urtësi*, dhe me besimin e patundur në vetvehte e me këmbënguljen e guximshme (IV, 180), sigurohet fitorja, paqa dhe drejtësia, të cilat arrihen vetëm «përmes gjakut dhe mizorivet të luftës» (VI, 274), vetëm, «po të mbështeteshin më tepër në armët» (III, 130). Prandaj kundër armikut, vazhdon kryetrimi, duhet të shtiem në

a) F. Noli, «Historia e Skënderbeut», Tiranë, 1962, f.36.

punë «më fort urtësinë dhe mënçurinë sesa zjarrin e zakonshëm të zëmrës» (IX, 360). Dhe mënçuria dhe urtësia, mëndja e njeriut, mposht gjithëçka, akoma edhe fati, që e çduk trimëria: «Është vështirë që fati ta gabojë mendimin dhe të mos i shkojë pas trimërisë» (IV, 180), thotë kryetimi. — Kështu mendonte dhe kështu vepronte Skënderbeu dhe ushtarët e tij, të cilët i mësonte dhe i edukonte me durim e këmbëngulje, duke u theksuar njëkohësisht se mosbesimi dhe mos-përbuzja ndaj armikut duhet të shoqërohen nga besimi në vetvehte: «Luftrat duhen bërë me besim në vetvehte dhe pa përbuzur të tjerët» (II, 105). Kjo është, përfundon Skënderbeu, *porosia e parë*, e lënë që nga themelonjësit e lashtë të ushtërisë.

Vendimtare në taktkën e Skënderbeut dhe dëshmitare të mënçurisë dhe urtësisë së tij janë edhe konditat objektive të vëndit dhe të kohës. Vëndi i Shqipërisë, thotë Skënderbeu, duke theksuar rëndësinë e tij në përballimin e armikut, «prej natyre shumë i mbrojtur», është gjëja më e aftë, më e përshtatur «për të prapsur çdo dhunë» (II, 98). Dhe Barleti, në konformitet me stilin e tij, e thekson rëndësinë e vëndit duke thënë se ai i *ndihmon shpesh vetvehtes*: «Vec kësaj, atyre u jepte dorë për çdo gjë edhe vëndi, i cili i ndihmonte kështu vetvehtes» (V, 199). Por vendi, që të mund të japë përfundimet e pritura, duhet *të njihet* mirë, me pëllëmbë, siç e njihet Skënderbeu, i cili, pikërisht për këtë qëllim, «Shpesh vizitonte Krujën dhe vëndet e qytetet e tjera, shkonte sa këtu atje i papërtuar, këqyrte e vërente çdo gjë me kujdes, male, kodra, pyje, gryka, lugina e çdo skutë, me qëllim që të nxirrte se me ç'menyrë mund ta bënte dikur

luftën kundër një armiku aqë të madh me humbje sa më të vogël të ushtarëvet të vet» (II, 89). Dhe këtë punë e bënte Skënderbeu jo vetëm në përgjithësi, por edhe në çdo rast para përleshjes me armikun (II, 108) — dhe jo vetëm ai vetë, por bashkë me gjithë ushterinë (IV, 182, III, 134 etj.), e cila prandaj e njihet vendin gjithashtu me *pëllëmbë*, si vetë kryetrimi. — Koha gjithashtu është vendimtare, por kur e përdor mirë, siç e përdorte Skënderbeu, i cili sulmonte shpesh natën (V, 207, X, 405), herët në mëngjez ose kur del dielli, por në drejt që rrezet t'u binin armiqvet në sy për t'i penguar (XI, 464), në piskun e vapës, kur armiku është i zgajtur ose i shpërndarë por edhe në kohë të keqe (II, 106), në shi e në borë, në stuhi e bubullimë (VI, 236) etj. Dhe sulmi në kohë të keqe, kur «rrufetë dhe vetëtimat bashkë me erërat e fuqishme» të shtien frikën, është shumë përfundimprurës, sepse armiku «shumë pak» e pret në këtë kohë një gjë të tillë. Prandaj Skënderbeu i këshillonte ushtarët duke u thënë se «ajo kohë sidomos duhej përdorur kundër armikut» (VII, 303). Dhe s'ka dyshim se *koha* dhe *vëndi* i Shqipërisë kanë qënë mësonjësit e drejtpërdrejtë të Skënderbeut dhe të ushtrisë së tij në taktykën luftarake. Prandaj ai thoshte shpesh: «Koha dhe vëndi do të na mësojnë si jo më mirë» (VII, 315), sepse ato, bashkë me rregullin e përsosur dhe arësyen e drejtë të luftës, janë të afta «jo vetëm ta ndiellin fatin», por «edhe ta detyrojnë» që të dalë faqebardhë (II, 111).

Në taktykën e Skënderbeut spikatin për mëncuri dhe urtesi tërë sistemi i masavet mbrojtëse, që ai zbaton. Këto kanë për qëllim të mos të të gjejnë kurrë të *papregatitur* dhe t'i heqin armikut çdo mundësi

shfrytëzimi të tokës e të vëndit të sulmuar, siç janë, p.sh., përforcimi i qytetevet dhe furnizimi me ushqime për popullsinë, shpërngulja e popullsjsë dhe e gjësë së gjallë në vënde të sigurta etj. (IX, 362).

Mënçuria dhe urtësia taktike e Skënderbeut shkëipi-
qen me tërë madhërinë e saj si një mënçuri dhe urtësi *shqiptare*, në faktin se ai e mbështet përcaktimin dhe vlerësimin e situatës konkrete dhe të planit të veprimit në mënçurinë dhe urtësinë kolektive, në përvojën e përbashkët, në nevojën e shoshitjes së saj nga e gjithë masa e ushtarëvet dhe e bashkëluftëtarëvet. Këtë nevojë ai e ndjen aqë më të madhe, sa më i madh është rreziku që përballojnë. Kështu, në rastin, kur atdheun e sulmon tradhëtari Hamzë, që e njihte mirë vëndin dhe tërë taktikën ushtarake të shqiptarëvet, ai e shtron çështjen kështu: «Është nevoja, pra, që ne të ngjitemi në majën më të lartë të urtësisë, të një urtësie që s'është parë ndonjëherë, të mendojmë se me ç'mënyrë edhe vëndin ta shpëtojmë nga rreziku, edhe lavdinë e mëparëshme dhe emrin e madh, që kemi gjer më sot nga sa e sa vepra trimërore, ta ruajmë dhe ta rritim edhe më me ndonjë fitore të shënuar e të papërgjakur, gjë që ndodh rrallë» (IX, 362). Kjo mënyrë veprimi e shoshitjes kolektive të çështjevet të luftës, e mbështetur në gjykimin dhe mënçurinë e masavet, është baza më e rëndësishme e sukseseve të Skënderbeut; ajo u ngjet «Kuvendevet» ose «pleqnivet» tona popullore dhe, me sa duket nga përgjigja, që u jep Pjetër Perlati të dërguarvet të Sulltanit «se s'kish marrë shëmbëll nga *të parët* që të bënte diçka pa u këshilluar me ushtarët e vet, të cilët i kishte shokë të mundimevet dhe të rreziqevet, dhe të largonte nga

bisedimet me armiqtë ata, bësnikërinë e të cilëvet e kishte zgjedhur mbi të gjitha për të mbrojtur mbretërinë e Skënderbeut, lirinë epirote, jetën e tij më në fund» (IV, 191), del që kjo është e stërlashtë për popullin dhe ushterinë shqiptare, një *zakon i tyre*, prandaj edhe i Skënderbeut, i cili, thotë Barleti, edhe në rastet, kur ishte i prerë në mendimet e veta, «e kishte zakon të mos bënte asgjë pa u këshilluar me ushtarët» (XI, 430). Në këto shoshitje kolektive, të cilat ai i organizon dhe i realizon me sukses e urtësi të veçantë, kërkon jo vetëm «*të këshillojë*», por edhe «*të këshillohet*», në mënyrë që të sigurohet fitorja (IX, 361) sepse, siç, e tha më lart, ai nuk do t'ia imponojë mendimin e vet askujt, por të pranohet mendimi, që është më i drejtë. Prandaj Barleti na thotë se çështjet, kur e do puna, shoshiten jo në një, por «në shumë mbledhje ushtarake» (IX, 358), ndërsa Skënderbeu është ushtarëvet, kur diskutohet plani i rrëthimit të Beratit: «Katër do t'i bëjmë sytë rrëth murevet, me kujdesin më të madh do të ruajmë se mos na vijnë armiqtë, kështu që ju të jeni të siguruar prapa shpine dhe të luftoni pa asnje frikë. Po erdhën, ne ose do t'u lëshojmë rrugë, ose do t'i përballojmë, si ta sjellë rasti dhe si ta dojë puna, si ta vendosni ju vetë. Gjithë planin e rrëthimit ne do t'ia përshtatim dëshirës suaj» (VII, 316). Kjo do të thotë se pjesëmarria në këto diskutime e shoshitje duhet të jetë e gjallë dhe *aktive*, duke mbajtur parasysh vetëm interesin e përbashkët, fitoren. Prandaj Skënderbeu, duke mbajtur parasysh gjithëmonë interesat e atdheut, u thotë në një rast tjetër ushtarëvet: «Unë... nuk kundërshtoj e nuk e quaj të pavlerë asnje send që do të çmohej se do të ishte për dobinë dhe

nderin e të gjithëvet.» (IX, 363). Kjo pjesëmarje, pra, është një *detyrë e lartë patriotike*, që ka për qëllim imediat përcaktimin më të drejtë të *planit të veprimit*.

Plani i veprimit në përgjithësi dhe forma e zbatimit të tij në shtjellim e sipër, në *betejë*, në veçanti, përcaktohet, me sa u tha më sipër, mbi bazat objektive të gjëndjes së forcavet armike, të kohës, të vëndit dhe të përvojës e mënçurisë kolektive. Por Skënderbeu fut këtu edhe këta faktorë të tjera me rëndësi, që e bëjnë të mundshëm zbatimin e këtij plani në betejë e sipër: karakterin mbrojtës të luftës së popullit tonë, faktorin psikologjik të frikës e të hutimit, që është në disfavor të armikut, dhe së fundi aftësinë luftarake të ushtrisë shqiptare. Edhe këta faktorë tregojnë se mënçuria dhe urtësia taktike e Skënderbeut spikat si askund edhe në këtë pikë. Dëshmitarë për saktësinë e saj janë vetë *përfundimet e arritura, praktika*.

Rëndësinë e faktorit të parë Skënderbeu e thekson duke u nisur nga e vërteta, se lufta për mbrojtjen e atdheut i bën njerëzit të papërkulur, sepse ajo ushqehet nga dashuria për atdhe, për liri e pavarësi. «Guximi i atij që mbrohet», u thotë kryetrimi ushtarëvet të tij, «duhet të jetë më i madh, trimëria e tij quhet zakonisht më e madhe se sa e atij që shkakëton dhunë. Ata kërkojnë vetëm plaçkë, vërsulen kundër nesh të shtyrë vetëm nga lëkmia për të sunduar. Por ju, që të mos jeni plaçkë në duart e tyre, jepni të gjitha provat e trimërise, kryeni detyrën ndaj atdheut, për të cilin kurrë s'duhet kujtar se është derdhur tepër gjak, sepse dashuria për të ia kalon çdo dashurie tjetër» (II, 105). Dhe s'ka dyshim se madhështia e luftës shqiptare nën Skënderbeun qëndron edhe në karakterin mbrojtës të saj.

Lidhur me faktorin e dytë, thjesht psikologjik, Skënderbeu thotë se në luftë vlen mbi të gjitha *befasia*: *armikun ta godasësh atëhere dhe atje ku s'e pret* (IX, 362). Që këndej forma kryesore e luftës për Skënderbeun është ajo e luftës së pritavet, jo e luftës së hapur. Lufta e pritavet, për arësyen psikologjike që përmendëm më lart, ka më tepër efekt në favor të atij që mbron vendin dhe në dëm të armikut. «Më mirë», arsyeton Skënderbeu, «të matesh me 10 burra sheshit e duke ditur përsë, sesa me dy pa ditur se ku e pse, sepse çdo gjë e fshehtë dhe e papritur të shtie frikë më tepër e të duket më e madhe». (V, 206). «Prandaj», vazhdon ai, «*kshumë kapedanë* dhe ushtëri të dëgjuara janë shpartalluar më tepër nga pritat se sa në luftë të hapur» (V, 205–206). Në luftë të hapur humbjet janë më të mëdha, kurse Skënderbeu s'mund t'ia dilte kundër mizërisë otomane me humbje të tillë, sepse, thotë, «për Tirinan^a) është më e vogël humbja, çmohen më pak dyzet a pesëdhjetë mijë të vrarë se sa pér mua njëqind nga ju» (IX, 361). Dhe i këshillon ushtarët që të ruhen «nga loja e rrezikëshme» e luftës sheshit, duke theksuar me të madhe: «Me të vërtetë, për ne asnjë mënyrë luftimi nuk është më e mundëshme, asnjë taktkë ushtarake më e sigurtë për t'u ndjekur në mes të një llumi aqë të madh njerëzish, sesa ajo që të mos i japim kurrë kundërshtarit mundësinë për t'u përleshur, që të mos hyjmë kurrë në lojën e rrezikëshme^{b)} për gjithë fatin tonë, edhe sikur fitoren ta shikojmë të sigurtë» (IV, 181). Me këtë mënyrë, va-

a) Sulltani, i cili quhet shpesh nga Barleti *tiran*, otoman etj.

b) D.m.th. në luftën sheshit, frontale.

zhdon kryetrimi, «ne duhet të bëjmë me kujdesin më të madh e me mënçurinë më të madhe që dëshirat e prapa të Otomanit të dështojnë dhe armiku të korret pak e nga pak, sipas rastit që do të na japë koha dhe vëndi» (po aty).

Aftësinë luftarake të ushtrisë së tij Skënderbeu e konsideron si faktorin më të rëndësishëm, që qëndron mbi çdo faktor tjeter në taktkën e tij. Këtë ai e tregon, ndër të tjera, edhe me këto fjalë, që u thotë në një rast ushtarëvet: «Nuk do t'ju them «bjeruni», o epirotë, por «lidhini», ashtu siç e kini zakon, që të mos thonë këta armiq se nuk i mundët ju, por Modrisa dhe lugnat e Mokrës,» (VII, 304). Dhe s'ka dyshim se këtë taktkë të Skënderbeut, me të cilën ai korri kurdoherë suksese madhështore e lavdiplotë, e bënин të mundur, përvëç të tjeravet, mënçuria dhe aftësia luftarake e ushtarëvet, përvoja e tyre e pashoqe në luftë. Me këtë përvojë, ata mund të shfrytëzonin si duhet edhe faktoret e tjerë objektivë, si kohën dhe vëndin e Shqipërisë me grykat dhe malet e luginat e saj, nga ku këta bij të shqipes me kryetrimin në krye lëshoheshin si rrufe e vetëtimë, pa pritur e kujtar, mbi armikun gjakatar, duke bërë në të kërdinë e duke e mbuluar me turp të pashlyer. *Befasia* është kështu tipari taktil kryesor, që e tregoi Skënderbeun «mjeshtrin më të madh të pritavet» (XII, 422).

Vendimtare dhe lidhur me befasinë është edhe shpejtësia, e cila «shpesh i përbys planet dhe i shpërndan e i ngatërron radhët» (X, 409), duke siguruar fitoren (XI, 460). Edhe kjo spikat në taktkën e Skënderbeut, aqë sa vetë armiqtë e quajnë kryetrimin tonë «rrufe e vetëtimë» (XI, 456).

Taktikën e zbatojnë njerëzit, që përbëjnë faktorin kryesor, prandaj problemi më rëndësor del këtu për Skënderbenë ai i ushtërisë, i organizimit, i kalitjes, i disiplinës dhe i përdorimit të saj. Skënderbeu e di se lufta kundër Turqisë është *fatale*, d.m.th. e paevitueshme, e vazhdueshme dhe plot rreziqe. Ai është i bindur se, sikur të kish shpresë që t'i jepnin fund luftës me një përleshje të vetme sheshit, do ta vinte me gjithë qef në rrezik «kokën» e tij bashkë me «trupin» e ushtarëvet. «për t'u siguar pasardhësvet qetësinë dhe paqen e përherëshme. Por», thotë, «armiku ngrihet gjithëmonë mbi ne me forca të reja, luftra ngahera të reja na presin.... Ne do të derdhim djersë ngahera në luftra të reja, do të rrethohemi nga rreziqe të reja. Për këtë, me ç'më duket, është destinuar Epiri, për këtë kanë lindur zverku dhe koka jonë». (IX, 361). Prandaj Skënderbeu e përdoite ushtrinë me nikoqirlliëk të madh, duke mbajtur mënjanë rezerva dhe duke hedhur në betejë një numër jo të madh forcash, jo vetëm sepse «janë të pakët» (po aty), por edhe në bazë të një parimi tjeter takтик, se «mizëria e ushtarëvet ka qënë në të shumën e herës shkak rrëmuje dhe pengese për fitoren» (XI, 450), sepse s'ka rëndësi numri, por *shpirti* i tyre (III, 147). Prandaj Skënderbeu thoshte: «kapedani apo komandanti, që nuk ditë thyejë armikun me tetë mijë ose me 12 e shuma, ai s'ka se si t'ia arrijë me asnje mënyrë fitores me forca më të mbëdha». (Xi, 449–450). Dhe Barleti na thotë se njerëzia e lavdërojnë dhe e admirojnë Skënderbeun «për këtë sidomos», se «me forca shumë më të vogla» ai pati gjithë ato fitore «gati të pabesueshme» (II, 102–103).

Për t'i patur këto përfundime, ai i kushtonte një kujdes të madh prebatitjes dhe stërvitjes fizike të ushtarëvet. Stërvitja është kushti themelor për fitoren, prandaj, thotë Skënderbeu, «ata kapedanët e vjetër fort të lavdishëm nuk kanë dashur aqë që ushtritë të jenë të panumura, se sa që të jenë të stërvitura në armë» (XII, 478). Ai udhëhiqej nga parimi se plogështia dhe rehatia janë shkak çburrërimi e demobilizimi, qullosojeje dhe vyshkjeje, prandaj ai i qorton këto të meta rëndë (VII, 322), qorton me buzë në gaz *epirotët* që «paskan vënë fort dhjamë nga fitoret e shuma e qënkan bërë delikatë» (po aty). Këto të meta ai i lufton duke e stërvitur dhe kalitur ushterinë «*me udhëtime të gjata*» nëpër gjithë vëndin, male, kodra, pyje, gryka, lugina, me qëllim edhe që ta njihnin mirë vëndin, siç thamë më lart, por edhe që t'i merrte mëntë armikut e ta fuste më lehtë në grackë dhe mbi të gjitha për të mos i mësuar ushtarët me plogështi e për t'i ruajtui prej saj (V, 196, 203, VI, 217, VII, 296 etj.) por edhe «*me mësymje të pandërprera e me plaqitje të visevet armike*», duke kujtuar fjalët e Fab Maksimit: «Me udhëtime e me ndrrim vëndi ushtria bëhet më e përmendur e më e shëndoshë» (II, 89), «*me punë, mund e pagjumi* të paprerë» (XIII, 488) etj. Dhe ushtarët e Skënderbeut ishin vazhdimisht në një lëvizje e mobilizim aqë të pandërprerë sa që Barleti thotë në një rast: «Ata ecnin natë e ditë dhe mezi pushonin aqë sa është nevoja natyrore e trupit, duke ngrënë bukën me rrëmbim» (XI, 460). Poroositë e tij Skënderbeu, si në çdo rast i zbatonte edhe në këtë pikë i pari vetë (XIII, 486), sepse ai u përmbahej jo vetëm fjalëvet, por edhe vepravet, duke u bërë në

çdo rast shëmbell përtë tjerët (I, 76, IX, 354, 363, X, 404 etj.) dhe duke i kthyer ata në imitonjës të denjë (XI, 460) dhe në roje të pafjetura të atdheut (XI, 452, 462). Bashkë me këtë ushtria e Skënderbeut, e edukuar prej tij dhe në bazë të moralit popullor, ishte shëmbell përrregullin, për disiplinën e ndërgjegjëshme dhe për iniciativën e pastërtinë morale të saj, gjëra përtë cilat Barleti thotë me admirim: «Me këto mënyra ndoshta u ruajt dhe u rrit përvite me radhë me aqë lavdi e fatbardhësi mbretëria» (IX, 354). Dhe Skënderbeu, krenar përkëtë ushtri të tij të mbrekullueshme, u shpreh atyre në çdo rast kënaqësinë me fjalët më të përshtatura, si: «Unë e shoh, o ushtarë të mij fort të dashur, se secili prej jush, pa urdhër të komandantit, pa porositë e kapedanit, qëndron i gatshëm me gjithë zemër, mban rrëgullin, u shkon prapa flamujvet dhe bajraqevet të veta, bën e rri roje, kryen detyrat dhe shërbimet prej ushtari me sedër; unë e shoh se ju jeni tërë kujdes, të pafjetur e të palodhur ditë e natë që s'rrini kurrë pa punë, kurrë në plogështi e pushim, por që jeni të ndezur e fort të gatshëm pa zegtha e mamuza dhe të patrembur e të pamposhtur përballë çdo gjëje që vlen përfitoren dhe që ndihmon përtia arritur fitores, që sulmoni, veç kësaj, dhe shtypni armikun me zëmër e trimëri të pazakontë, që s'e humbni kurrë besimin, as shpresën përfitoren. Prandaj në qoftë se i është lejuar dikur kapedanit apo komandantit të krenohet përushtarët e vet, kjo gjë mua më është lejuar në çdo kohë për ju, sepse me ju, sadoqë kemi qënë gjithmonë më të pakë se armiqtë, megjithëkëtë kemi dalë kurdoherë mbi ta» (XI, 462–463).

Por baza themelore e suksesëvet dhe e trimërisë

së Skënderbeut në krye të luftës vigane të popullit qëndron mbi të gjitha në *vetëdijshmërinë* e veprimit nga e gjithë masa e ushtariëvet, në unitetin e mendimit dhe të veprimit të tyre (IX, 360), që është rënja e çdo suksesi dhe baza e vetë trimërisë, sepse është trim, kush di se ç'bën, e kush lufton me pahir, s'bën gjë (II, 95). Prandaj Skënderbeu thoshte: «Natyra e njeriut s'i ka falur atij asnjë shkas më të fortë përfitoren se *sa vetëdijën e plotë të trimërisë*» (II, 107). Kjo *vetëdijë e plotë trimërie* e popullit dhe e ushtrisë së Skënderbeut buronte së pari nga vetë vetëdija e tyre e plotë për qëllimin e luftës së shenjtë, që u impoноhej të bënин përmbrojtjen e atdheut, sepse «*trimëria është e gatuar me domosdøjën*» (III, 147); ajo buronte së dyti nga sukseset e pa rreshtura që korrin kundër armikut dhe shtohej bashkë me to nga të rrezikuarit e përditëshëm, që i bënte jo vetëm të guximshëm, por edhe përbuzës të rreziqevet (VI, 250); ajo forcohej së fundi nga vetë zakcni i përgjithshëm popullor që t'i shoshitnin çështjet e luftës kolektivisht, zakon që e kishte edhe Skënderbeu, siç thamë, «që të mos bënte asgjë pa u këshilluar me ushtarët» (XI, 430). duke u thënë: «Unë s'jam nga ata, që t'i tërheq njerëzit në rreziqe pa ditur se ç'bëjnë» (III, 145), sepse ai synonte të siguronte unitetin e plotë të mendimit dhe të veprimit, qëllim që e shpreh më së miri edhe me fjalët: «ose unë të vij pas mëndjes suaj ose ju pas simes, (siç ka ndodhur gjithëmonë me ne).» (IX, 360). Me këtë mënyrë veprimi ata edhe s'i binden, kur mendojnë se s'e ka drejt (XII, 479). Dhe në këtë qëndrim aktiv të vetëdijshëm shprehet një nga vetitë më themelore të popullit tonë, rrënja e suksesevet të

tij, veti që Partia me aqë durim e urtësi ia ushqen sot në rrugën e gjërë të ndërtimit të jetës së re dhe të mbrojtjes së atdheut, duke ia ngritur çdo ditë e në shkallë më të lartë. Dhe trimëria shqiptare, e Skënderbeut dhe e ushtarëvet të tij, por edhe e gjithë popullit, është e pashoqe, e pathyeshme, e pazakontë, siç do ta shohim më poshtë, që mposht gjithëçka (I, 82).

Kështu, pra, tiparet e takikës dhe të mënçurisë që shprehet në të, si dhe gjithëçka tjetër që përbahet në figurën e Skënderbeut, e kanë bazën në popull. Këtë të vëitetë e thotë Skënderbeu edhe në formë përmbyllëse, me këshillat që i jep të birit mbi shtrat të vdekjes, se këto porosi dhe mësimë «ai i ka marrë nga prindi i vet» (XIII, 488). Këtë të vërtetë e ka ruajtur edhe gojëdhëna popullore, se Skënderbeu mëson edhe nga masat e thjeshta të popullit.^{a)} Por Skënderbeu e zbaton këtë takikë me mjeshtëri të rrallë dhe e ngre kështu në një shkallë më të lartë, prandaj e quan «një takikë tjetër më të dobishme luftarake» (II, 99), me të cilën zotohej që në Kuvendin e Lezhës t'i thyente hundët Muratit, sikurse ia theu, atij edhe të birit Mehmet, me besim të thellë në fuqinë e mëndjes dhe në vetëdijshmërinë e plotë të trimërisë së tij dhe të popullit të tij.

Këtë takikë të re të Skënderbeut e admirojnë njerëzia (II, 102–103) dhe jo vetëm miqtë, por edhe armiqtë (IX, 378). Dhe Murati, kur sheh se s'ka ç'ti bëjë, e quan këtë vigan të tokës arbërore «luan të pazbutur» (VI, 268), kurse Ferdinandi si të vetmin që mund të matet me tërë lashtësinë (X, 415).

Ky admirim i përgjithshëm përligjet nga përfun-

a) Këng. Hist. popullore, Tiranë 1956. f. 47. Nr. 4/10.

dimet kurdoherë të sigurta të Skënderbeut, të cilin s'e lajthit kurrë fati (II, 106), edhe në veprimet më të guximshme (V, 206), mbrekulli kjo e rrallë në shekullin e tij, sepse kudo që ai shkonte, «fitoren e kish të siguruar» dhe «me praninë e tij pushonte çdo furi, merrte fund çdo përlleshje» (XI, 454). Ai lëshohej mbi armiqjtë «si ndonjë riufe e vetëtimë» (XI, 456) ose «si ndonjë përrua që zbret nga malet pas shirash përbimitëse» dhe shëmb e rrëmben «çdo gjë me vehte» (XII, 469). Prandaj «për turqit s'kishte gjë më të tmeruar se fytyra e tij që u dilte përpara» (XI, 454). Dhe atij i trëmben edhe Sulltanët, Murati (III, 132, VI, 258) dhe Mehmeti, i cili edhe e admirion «fitoren epirote» (IX, 378) dhe shtanget para saj nga një farë habie (VII, 308), i tronditur fort e i turpëruar.

Trimëria e Skënderbeut dhe lavdia e tij, e cila del edhe më e madhe, po të mbahet parasysh edhe se me ç'armik kishte të bënte (VII, 290), u shërbën shpesh edhe vetë komandantëvet turq për të çfajësuar vehten para sulltanit për disfatat që pësonin nga dora dhe mëndja e kryetrimit tonë. Kështu bën Mustafaj para Muratit (III, 140), kështu Ballabani para Mehmetit (XI, 456), kështu bëjnë të tjerë dhe vetë ushtria turke, kur përpinqet të nxjerrë të larë tradhëtarin Moisi para Mehmetit egërsirë me *trimërinë e pathyeshme* të Skënderbeut dhe me «*thyeshmërinë njerëzore*» (IX, 350).

Por taknikën e Skënderbeut dhe përfundimet e saj, mënçurinë dhe urtësinë e tij në zbatimin e saj, zotësinë dhe trimërinë e tij të *pathyeshme*, e admiron sidomos populli dhe ushtarët e tij, ushtarë «me guxim e shpirt mbinjerëzor» (VI, 249), që «s'e kishin bërë

zakon të mundeshin» (VIII, 331), si vetë kapedani i tyre, «të mësuar të mos përfillnin hekurin» (po aty); e admiron ajo ushtri që, nga fjalët e kapedanit të vet, merr vesh dhe e lavdëron fort «kurtësinë e Skënderbeut» e nuk i bën ndonjë ndryshim, as e pret «me zëmër të thyer planin e tij» (I, 74); e admirojnë ata ushtarë, «në shpirt» të të cilëvet fjala e Kastriotit nguliset fort dhe trimërinë e të cilëvet ai e merr shëmbell për vehten e vet, duke u thënë: «unë do të marr si shëmbell për vehten time trimërinë tuaj» (II, 106) dhe duke vënë kështu në dukje rolin primar të ushtrisë në veprën e tij; e admiron populli, që e lindi dhe që e brumosi, që më nj'anë punon e m'anë tjetër lufton (VI, 266), që digjej çdo ditë në zjarrin e luftës dhe me *njerën dorë lëronte arat e me tjetërën mbante shpatën* (III, 100), e lavdëron ai popull, për të cilin armiku është detyruar të thotë, pasi ia provoi mirë shpatën dhe dorën: «Ve-tëm kjo gjindje ne na ka dalë e pathyeshme dhe që s'duron zgjedhë» (VI, 274); e admiron tërë Arbëria, «ku gjithë këta kapedanë, gjithë këta princër të pathyeshëm, gjithë këta popuj fort luftarakë janë në vrull të fuqisë me armë në dorë e të bashkuar!» (II, 95). Dhe këtë admirim populli e ka ruajtur të gjallë dhe e ka ngritur brez pas brezi gjer në quell me atë mënyrën e vet të idealizimit, duke e krahasuar shpatën e kryetimit të tij me *Ylberin* që del e lajmon largimin e shiut e të stuhisë.^{a)} Sepse shpata e Skënderbeut, e madhe dhe e ndritur, *Ylber* fitoresh e lavdie të përjetëshme në qielin arbëror, u jepte fund stuhivet e bubullimavet, rrufevet e gjëmimevet të luftës për liri e pavarësi të atdheut.

a) Këng. Hist. Popullore, Tiranë 1956, f. 46, Nr. 4/6.

2. — Vetitë morale. Një tok vetish të tjera të popullit tonë, me karakter sidomos moral, që kanë të bëjnë me ndjenjat e njeriut, me vullnetin e tij, dhe që shprehen përmes figurës së Skënderbeut, spikasin më me forcë për këdo dhe e tregojnë edhe më ndijshëm rolin simbolizonjës të figurës, sepse ato lidhen e çfagjen më direkt në veprim e sipër përmes aktevet të veçantë, që tërësojnë luftën e madhërishme të popullit tonë me kryetrimin e tij në krye. Atdheu, liria, pavarësia, mbrojtja dhe shpëtimi i tij, vendosmëria e paepur për ta mbrojtur e shpëtuar, bashkimi me zëmër i popullit, qëndresa dhe besimi i patundur i tij, guximi, durimi, këto e një tok vetish e idesh të tjera, me përmbajtjen, natyrisht, që u jepte atyre koha, janë në sfondin shqëror dhe vlojnë në mëndje e në zëmër të popullit në këtë periudhë nga më heroiket të historisë së tij. Këto vlojnë edhe në zëmër e në mëndje të Skënderbeut, prandaj ai, që në fillim të veprimtarisë së tij dhe në krye të popullit e të ushtrisë për çlirimin e vëndit u thotë atyre: «Asgjë të re, as të papritur nuk shoh këtu, që të mos ma ndjente më parë zëmra dhe të mos më mbushte me shpresë, sa herë që unë sillnja ndër mënd tërë mall edhe bujarinë e lashtë të popullit, edhe shërbimet e veçanta dhe zyrtare tuaja ndaj babës tim, Gjonit» (II, 72). Dhe duke vazhduar shton se qëllimet, ndjenjat, dëshirat e tij ishin edhe të tyret dhe përkëtë ai s'ka dyshuar kurrë: «Unë s'kam dyshuar kurrë, në asnjë çast të jetës sime, se, kur ruanja në zëmër këtë qëllim,^{a)} këtë dashuri për atdhe, kur ushqenja

a) D.m.th. çlirimin nga robëria turke.

këto ndjenja për liri, këtc dëshira të mia, që s'më ndaheshin, ishin edhe tuajat». (po aty). Ai vazhdon t'u shpjegojë se nuk u ish përgjigjur menjëherë që në fillim thirrjevet të tyre për t'u larguar nga sulltani dhe për t'u vënë në krye të popullit, jo sepse e kishte harruar atdhenë, nderin dhe lirinë, por sepse «punët ishin t'atilla, që duheshin bërë më tepër se sa thënë» (po aty), jo sepse ai dyshonte në besnikërinë e tyre apo s'ua dinte mirë *shprtin*, por sepse kishte frikë se mos ata i rrëmbente dashuria e madhe për liri e nuk e mbanin dot vehten, sepse këto punë s'bëhen me rrëmbim e ata kishin më tepër «nevojë për fie se sa përmamuza» (I, 72–73) etj.

Dhe së pari e mbi të gjitha qëndron këtu dashuria për atdhe (XIII, 488), e cila ia kalon çdo dashurie tjetër (II, 105), edhe dashurisë për fëmijët (IV, 177). Atdheu s'vihet me asgjë, atë njeriu duhet ta ketë gjithmonë parasysh, ta mbrojë edhe me gjak (XII, 472, XIII, 484), dhe të mos kujtojë kurrë se është derdhur tepër gjak për të, se është luftuar sa duhet për të (II, 105). Shpëtimi i atdheut është lavdia më e madhe dhe shpërblimi më i madh për njerinë (II, 106), mbrojtja e tij «provë e shkëlqyer besnikërie dhe zulme të përjetëshme» (V, 195). Dhe Skënderbeu, bashkë me popullin dhe ushtarët e tij, s'e harrionte kurrë atdhenë (I, 72), ai s'vinte asgjë përpara tij, as vehten e vet; ai e quante turp edhe martesën, gjersa një çip i atdheut, Sfetigradi, mbetej ende në dörë të armikut (VI, 232). Ushtarët e tij gjithashtu nuk mendonin veçse «shpëtimin e atdheut, të mbretërisë e të mbarë Epirit» (VI, 251).

Mbrojtja e atdheut është e lidhur me idenë e

lirisë, sepse pa atdhe s'ka liri. Lirinë Skënderbeu e quani të natyrëshme për njerinë (VII, 307) dhe popull shqiptar sidomos, me provat vigane që jepte pa rreshztur për mbrojtjen e saj, i tregonte gjithë botës se e ka «në gjoks e në zëmër» (I, 69, 71), por edhe «në ballë e në ushtë, në shpatë e në kraharon» (I, 74), në gjak e në shpirt, kudo. Prandaj kryetrimi «lavdëronte vullnetin e të gjithëvet dhe kujtimin e pasuar të lirisë në zëmrat e popullit» (I, 62). Prandaj në Shqipërinë e Skënderbeut ku burrat janë «të rritur në liri» (I, 73) dhe «gjokset e zëmrat e tyre krenare kushtuar për gjithëmonë lirisë» (VII, 315), «kudo oshëtinte emri i ëmbël i lirisë» (I, 69). «Liria buçiste në gojë dhe në gjokset e të gjithëvet» (I, 71).

Liria është e padhunueshme (VII, 314), ajo mbrohet me sakrificat më të mëdha, akoma edhe me jetën, dhe populli shqiptar, me zjarrin e papërmabjatur për liri, «sikur t'i paraqitet rasti më i vogël jo vetëm për ta fituar, por për ta provuar lirinë, atëhere s'mund ta largojnë atë *nga qëllimi* as një mijë shpatá, siç i thonë një fjale, as një mijë rreziqe, as *vdekja e sigurtë* dhe as rreziku i padyshimtë i të miravet dhe i jetës» (I, 73). Sepse liria siguron nderin e vërtetë të njeriut, i cili «s'vihet me asgjë» dhe pa të cilin vdekja është më e mirë se turpi (XI, 453), sepse robëria është turp e *shpirti i lirë* s'pranon më asnjë turp (VI, 276) e jo më robërinë (II, 97). Dhe popullit shqiptar iu paraqit rasti për ta mbrojtur lirinë dhe e mbrojti atë me mënyrën më të admirueshme. Barleti, i cili e shkroi veprën e pavdekshme të tij, siç thamë, në dhe të huaj, e kujton me mallëngjim trimërinë dhe heroizmin e pashoq të popullit të vet dhe shkruan: «Hej, medet, ku ka shkuar tani

ai shkëlqim i asaj gjindjeje, ajo bujari zëmrash, ajo *farë trimërije të pathyeshme?* Shikonin arbërorët mbretërini të coptuar, qytetet ca të pushtuara, ca të rrethuara, fushat stërgjyshore të mbuluara nga armët armike, gratë, fëmijët të treteshin në frikë e lote larg vështrimit të tyre trupat e të vetëvet t'u shqyheshin para syvet dhe vëndin të gjithë të kullonte gjak, e me gjithë këtë u pëlgente më mirë të dergjeshin në atë fatkeqësi dhe të *mbronin lirinë e përgjakur....*, se sa t'i jepnin armikut shënjen më të *vogël të zëmërlëshimit!*» (VI, 276). Me një dashuri të tillë për lirinë dhe me një vendosmëri të tillë për mbrojtjen e saj, populli shqiptar, rinia, ushtria, të gjithë e kush e kush më parë, i shkonin pas Skënderbeut, këtij shpëtimtari të lirisë dhe të të gjithë lavdisë (II, 99) dhe bashkë me të s'pranon të mundet veçse nga vdekja për hir të fitores (II, 107). Dhe përkrahja e popullit për Skënderbeun është e «admirueshme» (II, 86), sepse Skënderbeu çan në rrugën e tyre, sepse ai është i vendosur që t'u lërë qytetarëvet të tij ja «gjendjen e dikurshme» ja «shpirtin» e tij (IX, 380). Por lirinë e vërtetë ai e gjen në popull: «Lirinë nuk e solla, por e gjeta unë këtu» dhe: «Armët nuk jua solla unë, por ju gjeta të armatosur». (I, 73–74). Dhe dashuria e popullit për lirinë, gatishmëria e tij për ta mbrojtur atë dhe për t'i shkuar pas krye-trimit është aqë e madhe sa që ai e lë prapa Skënderbenë: «Sapo më shkeli këmba truallin tuaj», u thotë ai kapedanëvet dhë ushtarëvet, «sapo dëgjuat emrin tim, m'u derdhët me vrap të gjithë, më duallët përparrë kush e kush më parë, sikur të kishit dëgjuar se u ngritën nga varret etrit, vëllezërit, bijtë tuaj... Ju më latë prapa, ju m'i lidhët menjëherë duart ju më mbytët me shër-ju

bimet aqë të mbëdha dhe me një gaz shpirtërор aqë të madh, sa që duket se ju *më kini bërë tani aqë rob, sa edhe të lirë*. (I, 73). Me këto fjalë të zjarrta e plot kuptim dhe veçanërisht me frazën e fundit, të bukur e të figurëshme, që kemi nënvizuar, Barleti, në pajtim me stilin e tij, vë në dukje *prioritetin e popullit*, rolin e parë të masavet në veprën e Skënderbeut, bazën e saj popullore, objektive. Dhe s'ka dyshim se pa një mbështetje të tillë në popull, vepra e Skënderbeut do të ishte e paqënë. Këtë të vërtetë e pohon Skënderbeu me gojën e tij edhe gjetkë. Kështu në një rast ai u thotë ushtarëvet: «Unë nga ana ime s'guxoj t'ju zotohem pér asgjë pa mundin dhe gjakun tuaj» (VII, 296). Edhe shprehjet, që përmëndëm më lart, se ai do të marrë shëmbëll pér vehte trimërinë e ushtarëvet (II, 106) dhe se ata i vë përmbi luginat e Mokrës (VII, 304), këtë të vërtetë përbajnjë. Por më mirë se kudo këtë e thotë Skënderbeu në pyetjen që u bën të vetëvet: «Por përse doni që unë ta mbaj pér vehte me të padrejtë emrin e çlirimtarit?» (I, 73) — Çlrimi, pra është vepër e vetë masavet, e popullit, të udhëhequr nga Skënderbeu, i cili ngrihet kështu në një *simbol lirie* nga populli, por i cili është plotësisht i ndërgjegjëshëm pér rolin e tij vetëm si *udhëheqës*. Këto vështrime në histori, pamvarësisht nga forma, me të cilën shprehen, janë nga më objektivet, që hedhin poshtë çdo vlerësim të shtrëmbër, të sipërfaqshëm e të pavënd, që i kanë bërë disa *historianë* Barletit tonë të pavdekshëm, këtij shkrimitari po aqë *popullor*, sa edhe vetë Skënderbeu, që ai e pavdekëson në veprën e tij.

Mbrojtja e lirisë është një e drejtë natyrore, «një mbrojtje e nevojshme e jetës, që i lejohet jo vetëm

njeriut, në bazë të së drejtës njerëzore, por edhe kafshëvet që s'gjykojnë, në bazë të vetë ligjit të natyrës» (II, 96). Prandaj lufta për liri është një luftë e drejtë (II, 106, IX, 430) dhe e domosdoshme (XII, 477). E tillë është edhe lufta e popullit shqiptar sepse ai s'kérkon «ndonjë gjë të huaj» (VII, 316), ai lufton jo që t'i bjerë njeriu në qafë, por që të mos lejojë të merren nëpër këmbë të drejtat e tij. «Prej meje», u thotë Skënderbeu ushtarëvet, «s'kini patur kurrë shkaktë ankoheni se kam lejuar të merren nëpër këmbë të drejtat tonë apo se u kam rënë më qafë kot të tjerëvet» (III, 145) dhe vazhdon: «Arësyja e luftës që kemi duket sheshit që është e drejtë dhe gjithashtu e domosdoshme» (po aty). Dhe, në bazë të kësaj, i këshillon e nxit që «me trimërinë dhe guximin e paepur» të bëjnë «që luftën» e tyre «ta tregojë edhe më të drejtë vetë përfundimi i saj» (po aty). Për këtë, thotë Skënderbeu, duhet që ushtarët dhe njerëzit në përgjithësi, «para se të çveshin pallat dhe të përleshen me kundërshtarë, ta dinë se nga ç'anë qëndron më tepër e drejta» (po aty). Prandaj njeriu, që të ruajë nderin dhe dinjitetin e tij njerëzor, s'ka si t'i shmanget luftës së drejtë. Kjo do të ishte së pari një marrëzi apo çmënduri, sikurse është çmënduri edhe t'i ndezësh luftrat kot, pa arësyte drejtë. «Të kërkosh në kohë të qetë stuhinë», thotë Skënderbeu, «është çmënduri. Përkundrazi, t'i kundërshtosh asaj për çfarëdo arësy, kur të shtërngon koha apo nevoja, është urti» (XII, 477); së dyti, kjo do të ishte turpi më i madh për njerinë, sepse «s'ka gjë më të turpëshme, më kundër dinjitetit mbretëror për burrin trim, se sa të durojë nga frika që të drejtat e tij të shtihen në dorë nga të tjerët, që të rish, siç i thonë fjalës.

duar kryq, kur e sheh se gjithë e drejta qëndron në armët» (III, 145). Drejtësinë e luftës e tregon vetë *përfundimi* dhe detyrë e Skënderbeut dhe e ushtarëvet të tij, e gjithë popullit është që me trimërinë dhe guximin e tyre të sigurojnë fitoren, për të vënë në pah, siç e tha më lart, drejtësinë e luftës së tyre të shenjtë. Dhe ata kështu bënë, sepse «edhe të pësosh, kur e do puna, edhe të bësh trimëria, është arbërore» (XI, 438), duke siguruar kështu, me sakrificat dhe vuajtjet më të mëdha dhe me trimërinë e tyre «të pabesueshme» (X, 415), kurdoherë fitoren, lirinë dhe pavarësinë, nderin e atdheut. Sepse e drejta gjithëmonë fiton e «s'humbet kurrë», siç thotë populli, sepse ajo e bën njeriun trim, e burri trim s'i trëmbet vdekjes (VII, 296), as fatit, i cili është në dorë të tij (II, 106), sepse trimëria, siç e tha më lart, është e lidhur me *domosdojën* etj. Që këndeje edhe besimi i thellë i popullit edhe i krye-trimit në fitoren, e cila s'u mungoi pothuajse asnijëherë. Që këndeje edhe respekti, dashuria dhe adhurimi që gë-zonte populli ynë dhe lufta e madhërishme e tij në atë kohë. Dhe Skënderbeu krenohet «se mirësia dhe çështja e drejtë» (II, 99), që ai mbronte, ia kish bërë për vehte edhe zemrat e barbarëvet.

Mbrojtja e atdheut, e nderit dhe e lirisë shtron përpara një sërë detyrash konkrete dhe kërkon një tok vetish morale, që Skënderbeu i përfaqëson dhe i theks-on në mënyrën më të pëlqyer në atë kohë. Në krye të këtyre qëndron nevoja që shqiptarët të jenë të bashkuar në një front të vetëm, t'u largohen grindjevet dhe të vënë mbi interesin personal interesin e përgjithshëm, siç ka bërë Skënderbeu gjatë gjithë jetës së tij me luftrat e pa prera (XIII, 484) dhe me krijimin

e një shteti të përqëndruar shqiptar, duke i u përgjigjur kështu dëshirës së popullit për bashkim dhe duke realizuar kështu një nga detyrat kryesore patriotike të tij, që kërkonte dhe shtonte momenti. Vetëm kështu, thotë Skënderbeu, po të jenë të lidhur e të bashkuar, do të qëndrojnë të pathyeshëm para çdo armiku dhe sulmi të armikut. Sepse «s'ka asnë shtet aqë të fuqishëm dhe aqë të shëndoshë», arësyeton kryetrimi, «që të mos shëmbet dikur e të mos rrënohenet, kur u lëshon vënd mërivet dhe grindjevet të përbashkëta, kur vë përpara së mirës së përgjithëshme dobinë dhe përfitimin vehtiak» (XIII, 485). Dhe Skënderbeu e provoi në jetë se sukseset e tij, se «puna e Epirit», siç thotë Barleti, ka qenë e siguriuar nga «bashkimi me zëmër i popullsivet» (III, 147), nga bashkimi i shqiptarëvet në një front të vetëm (II, 99, XIII, 485). Pastaj vinë me radhë besimi i fortë, të cilin shqiptarët e kanë patur gjithëmonë të patronditur (III, 147 etj.), siç do të flasim edhe më poshtë, besnikeria ndërmjet njeri tjetrit, e kombinuar me harmoninë dhe dashurinë në mes tyre (IV, 179, V, 196, XIII, 485), ndjenja e përgjegjësisë së thellë për të kryer me çdo kusht dhe në çdo rast detyrën (I, 74, II, 107), durimi, qëndresa e paepur (II, 107, XII, 477) dhe datëkallëse për armikun (VI, 272), guximi, të cilin populli dhe ushtarët e Skënderbeut, së bashku me cilësitë e tjera të sipërme, e kanë patur aqë të madh, sa s'u gjëzohej dot (II, 108, VI, 275–276) etj. Me këto ndjenja e tipare Skënderbeu, që i shpreh në shkallën më të lartë për popullin e vet, i përgjigjet turkut barbar, kur i propozon ta bëjë tributar: «Mos ndodhtë, sa të jetë gjallë Skënderbeu, që ta shohë apo ta dëgjojë kush tributare tuajën këtë krahinë.

Jo, nuk do të lejonja, edhe sikur të na kthenit gjithë Maqedhoninë^{a)} dhe gjithë selitë e etërve tanë edhe sikur Otomani ta ndante me mua mbretërinë e tij, nuk do të lejonja që të njollosej me këtë turp emri epirotas Prandaj më kot na i grumbullove këtu gjithë ato shëmbëlla të huajsh, më kot na përshkrove fatin e zi të Peloponezit dhe skllavërinë e Azisë dhe të të tjerëve, sepse s'ka asnje shëmbell aqë të fuqishme, sa që të mund *ta tërheqë shpirtin e lirë në një turp të tillë*. (VI, 276). Kështu Skënderbeu mbronte nderin dhe lavdinë e atdheut dhe të popullit të vet, i dashur e i adhuruar nga të gjithë (VI, 231).

Skënderbeu është simbol adhurimi edhe për disa veti të tjera morale, që janë fort të dashura dhe të pëlqyera për popullin. Ai është shëmbell sakrfice, durimi dhe discipline për ushtarët e vet e për të gjithë (IX, 354), por edhe për gjithëçka tjetër, sepse ai u përbahet «jo fjalëvet, por vepravet» (XIII, 486) të cilat vlejnë më shumë. Ai është i matur, nuk dehet kurrë nga sukseset (II, 112) dhe nuk rrëmbëhet kurrë të thuash as nga epshet, as nga sharjet e fyterjet armike, duke iu përgjigjur Muratit gojëlëshuar: «Unë kam vendosur të luftoj me ty jo me sharje dhe me të bërtitura, por me armë dhe me mërinë e drejtë të luftës» (III, 131). Ai nuk rrëmbehet gjithashtu as nga zëmërimi më i madh, si në rrethimin e Beratit, kur «vërtitej sa këtu atje, duke kërcellyer dhëmbët me gojë të përgjakur» (VII, 329). Por Skënderbeu as nuk ligështohet para asnje mynxyre, edhe asaj më të madhes (XI, 447), madje më fort ai zëmërohet se sa dëshpërohet (XI,

a) Shqipërinë.

452), si i patrëmbur dhe i pathyeshëm që ishte. Skënderbeu është shëmbell edhe për qëndrimin *autokritik* ndaj vehtes. Bile ai e qorton hapur vehten para shokëvet edhe për çështje, që zor të quhen të qortueshme për të, si për qetësinë prej një viti me rastin e dasmës «duke kaluar kohën me dëfrime dhe argëtime private dhe publike», «larg armëvet, larg luftës dhe vetë trimërisë» (VII, 295), për faktin se s'ka *vepruar sa duhet* për çlirimin e atdheut, gjë për të cilën «Më tepër se kujtdo», thotë, «duhet të më vijë turp mu�» (VII, 286) etj. Me këtë mënyrë ai thekson si jo më mirë për të gjithë nevojën e mobilizimit më të madh dhe të cakrificavet më të mbëdha, që kërkonte gjëndja e atdheut në atë kohë. Ai pranon me kënaqësi edhe *kritikën* nga të tjerët, vërejtjet dhe sugjerimet e tyre dhe s'e ka zor të anojë nga mendimi i tyre, «si popullor që ishte» (VII. 297), kur sheh se gjërat, që ata thonë, janë të vërteta dhe në dobi të luftës e të atdheut. Por ajo që është e rrallë në këtë çështje, por edhe e denjë dhe e madhërishme, prandaj edhe e admirueshme, për Skënderbeun tonë, është se ai edhe qortimet e shokëvet, të kapedanëvet dhe të ushtarëvet, i pranon gjithashtu me kënaqësi dhe me mënyrat më mallëngjenjëse dhe më edukative për të gjithë dhe për çdo kohë. Kështu vepron ai, p.sh., me Vranakontin, të cilit i kish lënë në dorë mbrojtjen e Krujës dhe të cilin, kur u muar vesh lajmi se po vinte kundër Shqipërisë sulltan Murati vetë, deshi t'i japë zemër për t'i qëndruar armikut, duke e bërë këtë punë «me një kujdes të tepëruar» (V, 196), siç thotë Barleti. Atëherë Vranakonti, ky kapedan besnik, «iu përgjigj», vazhdon Barleti, «siç i kishte hije një besniku aqë të madh; ai burrë i dëgju-

ra s'mund të përgjigjej ndryshe». I zemëruar keq në fillim dhe si ndonjë i pikëlluar nga ardhja e tij, ai tha: «Ardhja jote, o Skënderbe, për secilin nga ne e pér të gjithë së bashku, qe aqë e mërzitëshme, sa edhe vetë fjala e papëlqyer që na mbajte, sikur kruanët të kishin përpara syvet jo ty, por Muratin dhe ushterinë e tij emërmadhe ^{a)}, pér të cilën po na flet» (V, 196). Skënderbeu, i kënaqur me këtë besnikëri e burrëri të bashkëluftëtarëvet të tij, «nuk solli asnjë kundërshtim në këto fjalë», por, pasi e çfajësci vehten me një mënyrë të lezetshme, «u nda nga kapedani dhe ushtarët», përfundon Barleti, «me përqafime» (po aty).

Skënderbeu është i adhurueshëm edhe pér *shpirt-butësinë* dhe *bujarinë* e tij, pér të cilën e duan dhe e admirojnë edhe armiqtë.

Skënderbeu është i dashur në popull edhe pér ndjenjat e tij të krenarisë kombëtare, të cilat i mishëron në shkallën më të lartë. Ai përsërit *të kaluarën e lavdishme* të popullit të vet, dhe bën që të rishkëlqejë nderi dhe lavdia e dikurshme e Arbërit (VII, 295). Por Skënderbeu edhe ua kalon të parëvet, aqë sa «miqtë e vjetër, ndoshta, e kishin zili lavdinë e burrit».

Këto ndjenja e veti morale të popullit e të Skënderbeut janë baza e trimërisë shqiptare, e cila hap «rrugë, si i thonë një fjale, përmes ujit, përmes zjarrit, përmes gjithë shtigjevet» (I, 81) dhe të cilën Skënderbeu e ka *në gjak* (VIII, 331) e të pathyeshme (VIII, 346) së bashku me popullin dhe ushtarët e tij «të patrëmbur e të pamposhtur...., me zëmër e trimëri të pazakontë» (XI, 462–463); me ata ushtarë «*të pashoq*»

a) E thotë me ironi.

(XI, 450), që s'kanë nevojë për fjalë, sepse janë «me të vërtetë trima» (II, 104) dhe jo vetëm trima, por edhe «shokë dhe burra kryetrima» (XII, 463), «luanë të komanduar nga luanë» (III, 111); me atë popull që preferon të shuhet duke mbrojtur «lirinë e përgjakur», siç u tha më lart, se sa t'i japë armikut «shënjen më të vogël të zëmërlëshimit». Dhe Skënderbeu është krenar për atdheun e tij, të cilin e quan «nënë dë seli fort e ndritur e kryetrimavet» (II, 105, VI, 274), për vëndin që s'i «kanë munguar mëndjet e ndritura» (I, 73) dhe që mund ta fitonte lirinë edhe me një tjetër çlirimtar, për «*gjindjen epirote* prej natyrës së vet krye-lartë» (III, 140), dhe «popuj fort luftëtarë» (III, 126), për, atë popull të tij që është «më tepër luftëtar se sa fetar» (II, 121), për popullin dhe ushtarët e tij, që ai i quan «filiza të ndritur nipiresh, kapedanë fort të dashur e të pathyeshëm» (I, 82), «burra jo vetëm trima, por edhe kryetrima» (II, 107, VII, 295 etj.), për ata ushtarë e bij të popullit që, me atë gatishmërinë e tyre, të cilës Skënderbeu s'i gjëzohet dot e thotë: «ç'është kjo mbrekulli e paparë?», derdhen e vrapijnë nga të katër anët e vëndit «vullnetarë» e kush e kush më parë dhe kërkojnë që të gjithë «armë e luftë». për të mbrojtur Skënderbenë, çështjen e tyre të përbashkët, atdheun, lirinë (II, 104), sepse Skënderbeu çan në rrugën e tyre, sepse çështja e Skënderbeut është çështja e tyre, e popullit, e atdheut të tyre të përbashkët. Dhe kryetimi ynë, duke shprehur gjimin dhe kënaqësinë e tij për kë-ta filiza e këtë popull, «me shaka e me të qeshur» lavdëron vullnetin e tyre të pathyeshëm e thotë: «Me të drejtë mund të qortohet natyra, që nuk i fali racës epirote me një shpirt kaqë të lartë një fat më të madh.»

(III, 147). Me të gjitha këto Barleti, dhe me frazën e tij të fundit veçanërisht, në pajtim me stilin dhe vështrimin e tij, shpreh edhe një herë rolin e madh, primar, të popullit në madhështinë e Skënderbeut, *në mbrekullinë shqiptare të shek, XV.*

Dhe me këto ndjenja krenarie dhe madhërie ai ndez ushtarët dhe vehten e vetë duke thënë: «Prandaj, ushtarë, tregohuni burra, merrni zëmër, merrni flakë nga lavdet e të parëvet, ndizuni nga zulma e ~~veprat~~ trimërore, qëndroni të fortë si lisat, ndiqni gjurmët, imitonи veprat e tyre» (XI, 459).

Më në fund figura e Skënderbeut del e madhëri-shme dhe qëndron e ngulur me dashuri si një simbol adhurimi në shpirt të popullit pikërisht për *karakterin popullor* të tij. Kjo shprehet së pari dhe mbi të gjitha në besimin dhe dashurinë reciproke ndërmjet Skënderbeut dhe popullit. Besimi i Skënderbeut ndaj popullit dhe ushtrisë së tij është i madh e i patronditur (VIII, 341). Me këtë besim ai vihet në krye të luftës së popullit e thotë në Kuvendin e Lezhës: «Shpëtimi është vetëm në duart tonë tjetër shpëtim s'ka» (II, 104). Me këtë besim ai u thotë ushtarëvet në betejë e sipër: «Unë s'kam dyshim aspak se ne do t'i dërmojmë ata menjëherë» (XI, 450) dhe gjetkë «shpëtimi i atdheut varet nga dora e ju të gjithëvet» (II, 106), dhe: «Është turp të pranosh ndonjë fat që s'është në dorën dhë shpatën tuaj», (po aty), sepse burrin trim s'e ndal asgjë (I, 81). Me këtë besim ai e shikon fitoren të siguruar (III, 147) dhe e thekson rolin primar të masës duke u thënë ushtarëvet: «Këtë paqe ..., ai mund ta kish vetëm po t'ia jepnit ju dhe ashtu si t'ia jepnit ju» (VII, 315). Po me këtë besim i përgjigjet Muratit bar-

bar: «Të jenë gjallë këta kapedanë, të jenë shëndoshë e mirë ushtria dhe populli ynë, gjithëçka tjetër që ne na ka humbur, ne do ta kemi... përsëri, besomë mua: gjithë shkatërrimet do t'i vemë rishtas në vënd. Këto punë të dorës së njerëzvet kështu e kanë, lehtë bëhen e lehtë prishen, mjafton që të mos mungojnë mjeshtrit e zotë duart e forta» (VI, 276).

Karakteri popullor i Skënderbeut shprehet së dyti në marrëdhëniet e tij me ushtarët, siç e pamë edhe lidhur me taktkën dhe siç mund ta shikojmë edhe në raste të tjerë të veçantë. Skënderbeu i don fort ushtarët dhe kujdeset për ta si ndonjë prind i vërtetë. Ai i njeh një për një e emër me emër, njeh fytyrat e tyre dhe di numurin sa janë (IX, 361); ai u afrohet e i prek me dorë, i përkëdhel e u jep zëmër me buzë në gaz, kur trëmben ndonjëherë nga rrufetë e vetëtimat, që i quajnë si ugurzeza për ta (VII, 303). U shkon pranë të plagosurvet, i ngushullon e i fërkon me dorë kokë më kokë «duke lënë mënjanë madhështinë e kapedanit» (VII, 209) si «një nga vegjelia» (po aty). Ai, me natyrën e vet prej ushtari» (po aty), kujdeset për ta akoma edhe kur grinden për ndonjë çështje personale, por kur doherë me buzë në gaz «si gastor e popullor që ishte» (IX, 377). Ai përkrah e lavdëron iniciativën e tyre, që i pëlqen fort, «kryetrimit që s'e kish shokun në urtësi» (VI, 233) dhe në çdo rast, lutjet e ushtarëvet, që i derdhen rreth e rrotull, «ia zbutin zëmrën kapedanit popullor» (III, 159).

Karakteri popullor i Skënderbeut duket edhe në rastet, kur ushtria e tij ndihmon drejt përdrejt popullin në punë bujqësore. Kështu kur lajmi për ardhjen e armikut po merrete dhenë dhe me që gruri s'ishte

mbledhur ende i gjithë nëpër fushë, «u hodhë në atë punë fshatarë e ushtarë së bashku dhe, pasi e korrën, e shpunë të gjithë brënda murevet, një pjesë të spastruar, një pjesë me byk e kashtë bashkë» (IX, 363).

E madhe dhe e patronditur është edhe dashuria dhe besimi që ka populli dhe ushteria për Skënderbenë. Ushtarët e donin si askënd Skënderbenë, ata përgjëroheshin për të (II, 107) dhe s'e këmbenin me asnje dhuratë dashurinë dhe besnikërinë për të (V, 219); ata fjalën, veprat, gjithëçka ia përshtatnin vullnetit të tij, siç thotë Vranakonti: «Ne do të të ndjekim me gjithë zëmër kudoqë të na shpiresh. Fjalët, veprat, vetë kohën do t'ia përshtatim vullnetit tënd. Me ty e lehtë do të jetë pér ne dëbora, i butë dimri dhe e ëmbël gjithëçka dhe as mundimet, as vështirësitet, as ndonjë lloj rreziku s'ka pér të na rënduar nën udhëheqjen tuaj» (VII, 297). Sepse ai u përgjigjej si askush, ishte «përkryesi» më i mirë i qëllimevet dhe i aspiratavet të tyre (I, 73). Prandaj e quanin turp të mos i shkonin pas (IV, 162) atij, që u kish siguruar *nderin* dhe *lavdinë* (VI, 231), që i mësonte: «Një herë kemi pér të vdekur, por ja të vdesim trimërisht, ja të shpëtojmë besën e lirinë» (II, 104), të mos i shkonin pas ata, që vdekjen e quanin «më të mirë se turpin» (XI, 453). Prandaj ata luftonin me merak të madh pér të plotësuar dëshirat dhe porositë e tij, duke bërë kërdi në armikun (V, 208). Dhe, kur e shikonin të mërzitur pér ndonjë fatkeqësi ose arësyte tjetër, si në rastin e Balshit, përpinqeshin të mos e lëndonin, duke hequr dorë nga çdo zhurmë, shaka e lodër, ose duke e ngushulluar me ëmbëlsi, me ftyrën e tyre të përbajtur e me natyrën e matur, e duke çfryrë meurrejtje kundër armikut (IV, 170, VIII,

336). Ata pendoheshin kur thonin ndonjë gjë që s'i pëlqente atij (III, 130), dhe qanin edhe me lot, kur kujtonin se kish pësuar gjë (VI, 254) apo kur u dilte përpara fytyra e tij e dashur (V, 223); kaqë fort që ua kish bërë për vehte zëmrat me sjelljen e tij të pashoqe dhe tërë kujdes për ta (III, 146), zëmra që rrithnin njësoj dhe që shqetësoshehin fort për shpëtimin e tij (V, 215). «Kështu», përfundon Barleti, «begenia dhe karakteri popullor i burrit, por më tepër e djathta e tij e shënuar dhe trimëria e pashoqe në luftë, ua kish fituar krejt zëmrat ushtarëvet» (VIII, 350).

Populli gjithashtu e shpreh me mënyrat më të ndryshme dhe më mallëngjenjëse dashurinë dhe besimin ndaj kryetimit të vet. Ai i derdhet i téri e kush e kush më parë, kur, kthehet fitimtar, dhe e pret me gaz e mall në zëmër, me këngë e me valle, me dajre e me «gjithëfarë veglash», por edhe me lot në sy nga gëzimi, duke e mbytur me të puthura e përqafime dhe duke organizuar edhe sofa e gostira nga më të pasurat nëpër gjithë qytetet e nëpër tërë fshatrat e rrugët (I, 66, 67, 73, VI, 282 etj.). Me fuqinë e kësaj dashurie populli e ka ngulitur e skalitur aqë fort në mëndje e në zëmër figurën e Skënderbeut. saqë, thotë Barleti, «do të ishte më lehtë t'i shkulnje nga duart Herkulit topuzin, se sa të fshinje nga zëmrat e zjarrta të vegjëllisë dashamirësinë dhe dashurinë për Skënderbenë» (VIII, 334). Dhe kjo «dashuri e pabesueshme e epirotëvet»^a), siç thotë Bardhi, ndaj Skënderbeut është dëshmja më e shëndoshë për të hedhur poshtë pohimet e përcipta të «historianëvet» dhe për të pranuar

a) F. Bardhi, v.c. f.73

objektivitetin e Barletit, sepse kjo dashuri konfirmon «mendimin e përgjithshëm të kombit tonë»^a), i cili s'mund të gabojë, siç thotë përsëri Bardhi.

Po kaqë i madh është edhe besimi i popullit dhe i ushtarëvet ndaj Skënderbeut. Besimin e ushtarëvet ndaj tij Skënderbeu e quan të *mjaftë* përfitoren (IX, 363), kurse populli besonte se me praninë e tij «*mund të njallëshin edhe të vdekurit* dhe t'u ktheheshin prapë» njerëzvet të tyre (VIII, 336). Me këtë *hiperbolizëm popullor* Barleti shpreh madhërishëm dhe me mënyrën më të theksuar fuqinë dhe rolin e këtij besimi. Me një besim të tillë populli i qëndron besnik Skënderbeut gjer në vdekje: «Besnikëria e tyre ndaj tij», thotë Barleti, «duket fare qartë se kishte pér të mbaruar jo me ndonjë ndryshim të fatit, por *bashkë me jetën e tyre*» (VIII, 334). Dhe Skënderbeu, me besimin e tij «*të pazakontë*», si vetë populli, është krenar pér këtë besim e besnikëri të popullit të vet dhe e ngre atë lart duke pohuar se s'mund të harrojë kurrë «besën» e qytetarëvet, që ata treguan ndaj tij dhe që «s'ekanë harruar kurrë» (II, 96).

Këtij besimi dhe kësaj dashurie, kësaj lidhjeje të ngushtë të popullit me Skënderbeun, e cila është në bazë të *mbrekullisë shqiptare të shek. XV*, i trëmben armiqtë barbarë (II, 87), vetë sulltanët më të mbëdhënët të Turqisë, Murati dhe Mehmeti. Murati, thotë Barleti, «i matte fuqitë e Skënderbeut nga kërdia me nam e Ali Pashës pak kohë më parë dhe veç kësaj i trëmbej besimit që kishin gjithë popullsitet e Epirit tek ai dhe dashurisë që gëzonte nga princërit e krishterë, e cila po shtohej dita ditës» (III, 129). Mehmeti gjii-

a) F. Bardhi, v.c. f.74

thashtu, për të cilin Skënderbeu u bë një «datëkallës» i tmeruar, «i trëmbur gjer në palcë» (XI, 435) dhe «duke parë se ai ishte ngjitur në një majë aqë të lartë, sa që emri i tij u shtinte drithmën e tmerin gjithë të vetëvet, kishte frikë se mos për shkak të këtij emri të dëgjuar, që tanimë kishte marrë dhenë e mbahej kudo në gojë, gjindja dhe popujt e tij ngrinin krye dhe e rrëzonin nga froni» (XII, 467). Dhe në kohën, kur u përhap lajmi se Skënderbeu dovihej në krye të forcavet të bashkuara komandant i përgjithshëm i tyre në fushatën kundër Mehmetit, «për shtetin dhe fuqinë e Otomanit», thotë Barleti «të gjithë thonin e pohonin se do të binte në dëshpërim» (XI, 435). Dhe përfundon: «Kaqë e madhe ishte dridhma, kaqë e madhe ishte lemeria që i kishte zënë nga emri i Skënderbeut, kaqë i lemerishëm, kaqë i tmeruar ishte përturqit emri i tij» (XI, 436). Përkundrazi, ky besim i madh e reciprok i çduk Skënderbeut çdo frikë e dyshim në punët e tij, siç e pamë më lart (VI, 276 etj). Dhe pikërisht në këtë besim reciprok e në këtë dashuri reciproke, në këtë mbështetje e bazë të fuqishme popullore, në këtë shkrirje të përbashkët e në këtë unitet qëllimi e veprimi të luftës për liri e pavarësi, qëndron madhështia e veprës së Skënderbeut dhe të popullit të tij. Që këndeje rrjedh tërë fuqia dhe qëndresa, që këndeje buron tërë guximi dhe durimi, që këndeje trimëria dhe fitorja, lavdia dhe pavdekësia e tij dhe e popullit të tij. Që këndeje Skënderbeu dhe populli janë një brënda kuadrit historik të kohës.

— o —

Skënderbeu lindi, jetoi, veproi e vdiq për atdheun. Edhe në kohën, kur po lëngonte mbi shtratin e vdekjes,

ai kërkon armët e kalin për t'i dalë armikut përpara (XIII, 489), duke u dhënë bashkëluftëtarëvet këshillat më të mira dhe duke e mbyllur për jetë gojën me këto fjalë të zjarra: «Dilni, dilni, ushtarë, kundër armiqvet dhe barbarëvet, shkonit përpara meje, se po ju vij menjëherë nga pas» (po aty). «Kaqë fort që vlonë», përfundon Barleti admirimin e tij për kryetrimin, «në atë gjoks të zjarritë një zemër e zjarritë» (po aty). Kësh-
tu vdiq Skënderbeu, pasi u la bashkëluftëtarëvet të tij në kujdes, si një *prind i vërtetë shqiptar*, birin e tij të vogël e të dashur, Gjonin, me porosinë e përbashkët që gjithëçka ta vënë në *dobi të atdheut*.

Skënderbeu përfaqëson kështu në formë të koncentruar gjithëçka më të lartë e më të dashur të popullit të vet, vetitë e tij më të bucura e më të ndritura, dëshirat dhe aspiratat e tij më të zjarra për liri e pa-
varësi, mëndjen dhe zëmrën e tij, *shpirtin e tij*. Prandaj pas vdekjes bëhet një fugi që mban gjallë miémëdhënë^{a)} dhe që bën të ngrihet peshë për të thyer vargonjtë e skllavërisë dhe për të fituar sérish lirinë eëmbël. Me emrin e Skënderbeut nëna shqiptare rriste të birin e saj duke e nanurisur me ëmbëlsi:

«U bash trim si Kastrioti !»^{b)}

Me emrin dhe kujtimin e tij në zëmër bijtë e shqipes i rezistonit robërisë shekullore otomane duke i u përgjigjur :

«Por thuej Pashës e allajbegut,
S'lidhen të birt e Skanderbegut»^{c)}

a) N. Frashëri, «Hist. e Skënderbeut», VII, 152.

b) Këng. Pop. lirike, Tiranë 1955, f. 7, Nr.10, v. 19–20.

c) Këng. Pop. Historike, Tiranë, 1956, f. 289.

Po me emrin dhe fryshtën e Skënderbeut rilindasit tanë ia ndezën e ia ushqyen si jo më mirë popullit zjarrin e dashurisë për liri e pavarësi kombëtare.

Edhe gjatë luftës Nacional-çlirimtare, luftës më të madhe të popullit tonë, emri i Skënderbeut ndezi e i fryshtëzoi partizanët tanë trima, të cilët, siç thotë «Vajza trime shqiptare» luftonin edhe

«Për flamur të kuq e zi
Të Skënderbeut»^{a)})

Sepse partizanët tanë trima, këta bij të denjë të popullit e stërnipër lavdiplotë të Skënderbeut legjendar, i kuptonin thellë dhe i ndjenin të zjarrta në zëmër fjalët e Partisë Komuniste Shqiptare, që u thoshte atyre dhe gjithë popullit: «Ashtu si qëmoti, kur stërgjyshërit tanë me flamurin e Skënderbeut luftuan pa rreshtur zaptuesin e vendit tonë, kështu edhe ne, bij të denjë të tyre, me flamurin e Skënderbeut, të shkojmë në luftë kundër zaptuesit të ndyrë fashist dhe tradhëtarëvet për çlirimin e vërtetë të popullit shqiptar»^{b)}.

Në mbledhjen përkujtimore, organizuar në Tiranë, me rastin e 500 vjetorit të vdekjes së Skënderbeut, shoku Mehmet Shehu tha: «Skënderbeu ishte një vigan i mëndjes dhe i veprimit, por populli që luftoi me të, që e bëri atë të madh, ishte akoma më vigan, më heroik, më i lavdishëm.»

a) Këngë Pop. Historike, Tiranë 1956, f. 289.

b) Thirje dhe trakte të P.K. të Shqipërisë, Tiranë 1962, f. 61.

U dorëzua për botim në prill 1963. Doli nga shtypi në gusht 1968

Tirazhi: 1500 kopje

Formati: 78 x 109/32

Stash. 2204-65

Shtypur në NISH Shtypshkronjave «MIHAL DURI»
Stabilimenti i Botimeve Arësimore — Tiranë